Botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë / www.kmsh.al

DRITA ISLAME

Një fillim ndryshe për vitin e ri shkollor

ISSN 2226-7115

Viti XXIX / Nr. 9 / Shtator 2020 / Çmimi: 150 Lekë / www.dritaislame.al

Revista Drita Islame
në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

URTËSI

BOTA JONË

FAMILJA

REFLEKSIONE

PERSONALITETE

www.dritaislame.al

"Drita islame"
Botim i Komunitetit Mysliman
të Shqipërisë

DREJTOR
Dorian Demetja

REDAKTORË
Andrin Rasha
Mehmet Disha

DIZAJNI DHE FAQOSJA
Ejup Lila

KONTAKT:
Tel/fax 04 223 04 092
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXIX i botimit
Nr. 9 (452)
Shtator, 2020

ISSN 2226-7115

Artikujt
që vijnë në redaksi
dhe botohen,
nuk paraqesin domosdoshmërisht
edhe pikëpamjet e revistës.
Materialet e sjella në redaksi,
pavarësisht nëse botohen apo jo,
nuk i kthehen autorit.

PËRMBAJTJA

4 Një fillim ndryshe për vitin e ri shkollor / Dorian Demetja

6 Zemërimi dhe depresioni në aspektin islam / Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

10 Lajme / Aktivitete

14 Krijimi i bibliotekës personale / Nuredin Nazarko

16 Popullsia myslimane sot dhe nesër / Msc. Haki Sahitaj

20 Distanca që duhet mbajtur ndërmjet këmbëve 1 / Shkëputur nga libri "Argumente bazë të Fikhut Hanefi", të autorit Abdurrahman bin Jusuf Mangera, botim i KMSH-së.

22 Disa nga dobitë e dërgimit të salavateve / Mehmet Disha

24 Zoti ynë

26 Porosi madhështore në Kur'an / Imam Vehbi Ismaili

28 Qerim haxhiu - teolog, mësues dhe veprimtar i shquar në diasporën e shqiptarëve të egjiptit për çështjen kombëtare shqiptare / Kevin Haxhiu

32 Çdo njeri në brendësi e ka tregimin e vet të pikëllimit

33 Cili është shkaku i pikëllimit tënd?!

34 Edukimi i fëmijëve – sfida më e madhe e prindërve bashkëkohorë / Qani Sulku

36 Hirudoterapia (terapia me shushunja): Një mundësi për shërim / Mehmet Ramazanoglu

38 Letër Mësuesit!

38 Tregim

Një fillim ndryshe për vitin e ri shkollor

Viti i ri shkollor 2020-2021, fillon shumë ndryshe nga ç'jemi mësuar, për shkak të situatës së koronavirusit. Megjithëse fëmijët janë më pak të rrezikuar në këtë drejtim, duket se ka ende pasiguri dhe shqetësimi për çdo prind është i madh. Autoritetet na qetësojnë kur thonë se agresiviteti i virusit nuk është i njëjtë me atë të muajve mars-prill. Megjithatë, nuk duhet të neglizhojmë në këtë periudhë, pasi fillojnë shkollat, ulen temperaturat, rriten kontaktet nëpër ambiente të mbyllura e të tjera. Parë në këtë këndvështrim, kujdesi duhet të vazhdojë, madje duhet të jetë shumë herë më i madh, duke qenë se fëmijët do të jenë nëpër shkolla.

Shkolla është vendi ku jepet mësim dhe edukatë. Aty mësohet gjithçka në lidhje me jetën e më tej. Në fakt, edhe vetë jeta është një shkollë. Ajo është institucioni që hedh dritë mbi evenimentet jetësore dhe u jep nxënësve mundësinë të kuptojnë atë që ndodh rreth tyre. Shkolla dhe edukimi që jepen aty, përfshijnë pothuajse të gjithë jetën e njeriut. Ai gjatë gjithë jetës, zbaton e përsërit mësimet që merr në shkollë dhe, virtytet e aftësitë e fituara aty, janë udhërrëfyesi i tij gjatë rrugëtimit.

Mësuesi është një udhërrëfyes shembull, që i jep njeriut formë, si dhe njëkohësisht është krijesa "e shenjtë" e tempullit të edukimit. Vetë fjala e Profetit Muhamed (a.s.): "Unë jam dërguar si mësues", e shpjegon më së miri këtë. Ndikimi i mësuesit mbi individin është po aq i rëndësishëm sa ndikimi i prindërve apo i shoqërisë. Në një shkollë të mirë, mësuesi është ai që mbjell dhe që ruan farën e pastër e të pafajshme. Nxënësit mund t'i bëhet shembull i mirë dhe udhërrëfyes i saktë, një mësues që e ka perceptuar të vërtetën dhe që e ka kaluar çdo dituri më parë nga porta e ndjenjave të veta.

Librat që i jepen nxënësve në shkolla, qofshin libra të lëndës, qofshin libra me karakter fetar, romane apo poezi, duhet të jenë të tillë, që të arrijnë të zhvillojnë vullnetin, t'i japin forcë mendjes, vendosmëri shpirtit dhe shkëndijë shpresës. Çdo e dhënë e mësim përmendësh, që nuk premton ndriçim të mendjes e çlirim të shpirtit, është një goditje që i jepet zemrës. Një dituri që nuk ka për qëllim zbërthimin e enigmës mes personalitetit tonë dhe materies, nuk i sjell asnjë lloj dobie nxënësit, përveç njehsimit me botën e jashtme e distancimin nga vetvetja.

Në jetën shkollore, nxënësit i duhen mësuar së pari gjuha, besimi, morali e karakteri, pastaj duhet synuar ndërtimi i një personaliteti të shëndoshë mbi këto themele. Qëllimi i mësimit duhet të jetë përgatitja intelektuale e sociale në përshtatje me kohën dhe vendin ku jeton. Nxënësi duhet të shtyhet drejt përditësimit të dijeve, drejt një mënyre të menduari që nxit zhvillimin dhe suksesin në çdo fushë. Pasi të arrihen këto objektiva, duhet përgatitur specializimi i nxënësit për fe, art, shkencë, financë teknikë... E gjitha kjo është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me zhvillimin në paqe të shoqërisë, me moralin dhe besimin e saj, si dhe me sukseset në fushat e ndryshme.

Me këtë rast, megjithëse në situata të vështira e shqetësuese, shpresojmë që mësuesit dhe nxënësit të vazhdojnë mësimin me të njëjtin ritëm e zell. Duke iu uruar atyre vitin e ri shkollor, lutem që Zoti të na e prijë mbarë dhe të dalim me sukses nga kjo sprovë mbarëkombëtare.

| PRIM.DR.MED.SC. ALI F. ILJAZI |

Zemërimi dhe depresioni NË ASPEKTIN ISLAM

Kur Allahu i Madhërishëm krijoi njeriun, Ai krijoi brenda tij shumë emocione dhe dëshira, që ne i quajmë instinkte njerëzore. Këto përfshijnë cilësi pozitive, siç është njohja dhe shprehja e së vërtetës, dashuria, dhembshuria dhe dëshirat e plota fiziologjike si etja, uria dhe nevojat seksuale.

Ekzistojnë edhe cilësi negative si urrejtja dhe tërbimi që prodhojnë dhunë dhe depresion. Engjëjt që ishin dëshmitarë të krijimit të Ademit, a.s., ishin të vetëdijshëm për këto cilësi negative dhe hulumtuan krijimin e kësaj qenie të re e cila, sipas fjalëve të tyre:

"...A do ta vësh në të atë që bën çrregullime dhe që derdh gjaqet..." (El Bekare, 30)

Mirëpo Krijuesi i Gjithëdijshëm, ka mbjellë disa mekanizma mbrojtës në luftë kundër këtyre pasioneve negative.

"Njeriu është krijuar i dobët", thotë Kurani. Gjatë momenteve të dobësisë ne i nënshtrohemi qëllimeve të armikut tonë, shejtanit, i cili na "sulmon nga para, prapa dhe anëve", me qëllim që të na çorientojë nga vetëdija e pandërprerë mbi prezencën e Allahut. Kështu që, tërbimi në vete nuk është i natyrshëm. Kjo është shprehje e gabuar për zemërimin që çon deri te problemi.

Zemërimi (tërbimi) destabilizon mendimet. Ai çrregullon gjykimin normal, udhëheq në depresion, çmenduri dhe veprim të gabuar. Gjatë zemërimit njeriu mund të lëndojë fizikisht dhe verbalisht personin e dashur, lëndon personin tjetër sikurse kafsha, ose gjatë fazës së depresionit mund të lëndojë veten ose të bëjë vetëvrasje.

Kur zemërimi orientohet ndaj grupit të njerëzve, ai mund të shprehet me terrorizëm, qoftë kur drejtohet kundër një grupi njerëzish, feve apo popujve tjerë.

Plotësimi natyral i dëshirave normale, qoftë në kuptim të ushqimit ose marrëdhënies seksuale, është parakusht për parandalimin e zemërimit. Ekzistojnë shumë barna, ilaçe dhe hormone që ndikojnë në gatishmërinë dhe sjelljen tonë.

Është e njohur që hipoglicemia (niveli i ulët i sheqerit në gjak) ose tajitja tej mase e hormoneve të gjëndrës mbrojtëse (tiroide) ndikon në gatishmërinë tonë dhe shkakton zemërimin. Hormonet duhen mbajtur në baraspeshë, gjë që lehtëson harmoninë tonë shpirtërore.

Pejgamberi ynë, Muhamedi (a.s.), u dërgua për mbarë njerëzimin për të na mësuar sjelljen e bukur morale dhe vazhdimisht ka folur për kontrollimin e zemërimit. Një sahab e pyeti Pejgamberin (a.s.): "Më jep një këshillë të shkurtër për moralin në bazë të të cilit mund të shpresoj mirësi në këtë dhe në botën tjetër? Pejgamberi (a.s.), iu përgjigj: "Mos u zemëro."

Pejgamberi (a.s.), njëherë i pyeti shokët e tij: "Cilin e mendoni njeri të fortë?" Ndërsa ata u përgjigjën: "Ai i cili mund ta mposhtë dikë në luftë." Pejgamberi (a.s.) u përgjigj: "Nuk është kështu. I fortë është ai i cili mund të kontrollohet në momentin e hidhërimit."

Duhet bërë dallimi mes zemërimit si përgjigje natyrale në padrejtësi dhe tradhti dhe zemërimit joproduktiv si hakmarrje personale.

Me një rast Aliu (r.a.), duke luftuar u ballafaqua me njërin nga paria e idhujtarëve, e mposhti dhe deshi ta vrasë, kur ai në atë moment e pështyu në fytyrë. Aliu (r.a.), menjëherë u ngrit dhe u largua pa e vrarë atë. Njeriu vrapoi pas tij duke e pyetur: "Pate rastin të më vrasësh, përse nuk e bëre?" Aliu (r.a.), tërësisht i qetë u përgjigj: "Nuk kam urrejtje personale ndaj teje, kundër jush luftoj për shkak të mosbesimit tuaj ndaj Allahut. Sikur të të mbysja pasi më pështyve në fytyrë, atëherë lufta do të ishte hakmarrja ime personale, e unë në këtë nuk dëshiroj të marr pjesë." Pas kësaj, idhujtari menjëherë pranoi islamin.

Çfarë ndodh fiziologjikisht kur zemërohemi?

Rritet frekuenca e zemrës dhe tensioni i gjakut si pasojë e veprimit direkt të adrenalinës në gjak. Rritet fuqia jonë fizike, ndërsa zvogëlohet fuqia shpirtërore. Mendja jonë dhe fuqia e gjykimit mënjanohen dhe gjërat, të cilat në gjendjen normale mund t'i arsyetonim, bëhen të papranueshme. Organet e trupit tonë që zakonisht janë nën kontrollin tonë dalin jashtë kontrollit.

Pra, gjuha jonë, duart, këmbët dalin prej kontrollit. Personi, i cili nuk kontrollon dhe orienton zemërimin, mund të ndërtojë hidhërimin brenda vetes, pra ai mund të lëndojë fizikisht. Përveç depresionit dhe ndjenjës së shpirtngushtësisë gjatë fazës së mos paraqitjes së zemërimit, ritmi i shpejtuar i zemrës dhe tensioni i lartë i gjakut mund të dëmtojnë zemrën, madje duke shkaktuar në fund edhe sulm në zemër. Përveç dhunës gjatë fazës së zemërimit (sepse mendja nuk punon drejt) njeriu mund të biebjerë në vendim të gabuar në punën e tij ose në marrëdhëniet personale dhe kështu mund të ndikojë në ardhmërinë e tij.

Ilaçi i zemërimit

Ilaçi i parë preventiv është nga ndjeshmëria në provokime. Kjo duhet të jetë e domosdoshme që njerëzit të preokupohen me diç tjetër me qëllim të orientimit personal. Përveç përkujtimit ndaj Allahut, ose ibadetit, ekzistojnë edhe mënyra tjera që mund të ndihmojnë. Pejgamberi (a.s.), e ka këshilluar një njeri që të pijë ujë kur hidhërohet me bashkëshorten dhe ta mbajë në gojë pa e përbirë. Pas disa muajsh së kësaj këshille personi vjen te Pejgamberi (a.s.), duke e lajmëruar se këshilla e tij ka pasur sukses.

Meqë besojmë se zemërimi është shprehje e kontrollimit të shejtanit, nuk duhet lejuar që ai të marrë kontrollin. Allahu i Madhërishëm, në Kuranin Fisnik, urdhëron e thotë:

"E nëse ty të ngacmon ndonjë ngacmim prej djallit, ti kërko mbrojtje prej Allahut se vërtet Ai është dëgjuesi i dijshmi." (Fussilet, 36)

Pejgamberi (a.s.), ka këshilluar që kur jemi të zemëruar të ulemi ose të shtrihemi, sepse nuk është lehtë të godasim dikë kur jemi në këtë pozitë. Por, ilaçi më i mirë është të mendojmë për hidhërimin dhe dënimin e Allahut. A thua hidhërimi i Allahut është më i vogël se i yni? Dhe çfarë ndodh kur Ai shpreh hidhërimin e Tij? Ne, njerëzit që kërkojmë falje nga Allahu, së pari duhet të kërkojmë falje dhe të falim njerëzit e tjerë. Kur falim dikë, vendoset paqja dhe qetësia në zemrat tona.

Atributi i parë i Allahut, me të cilin ne myslimanët përkujtohemi, është që Ai është Mëshiruesi, Mëshirëbërësi. Allahu i Madhërishëm thotë: "Mëshira Ime mbizotëron hidhërimin Tim", ndërsa Pejgamberi (a.s.), në hadithin kudsi, ka thënë: "O bijtë e Ademit, kur hidhëroheni, më përkujtoni Mua." Pra, përkujtimi tek Allahu është ibadet i cili na ndihmon të kthehemi në rrugë të drejtë. Një prej emrave të Zotit është edhe El Halim, me kuptimin "I Butë". Gjithashtu duhet të lutemi Allahut që të kemi nën kontroll situatën që ka shkaktuar hidhërimin. Duhet kuptuar gjithashtu që kjo jetë, edhe pse është e dashur, është kalimtare, dhe nuk duhet harruar vdekja dhe nuk duhet lejuar ta shkatërrojmë botën e përhershme për shkak të kësaj bote të përkohshme.

Larja me ujë të ftohtë ose dushi i ftohtë gjithashtu është i dobishëm dhe i efektshëm.

Me rëndësi është orientimi i energjive në bashkëveprim me diç tjetër. Por, sjellje kulmore dhe shembull i edukatës islame është të veprohet kundër asaj që pret provokuesi. Nëse provokuesi pret që ta kritikoni ose t'ia ktheni me nënçmim verbal, atëherë duhet përgjigjur se e doni atë, duke ia përmendur cilësitë e tij të mira. Nëse pret që ta sulmoni fizikisht, atëherë duhet përqafuar dhe falur.

Shpirtngushtësia (Depresioni)

Shpirtngushtësia është gjendje e mendimeve pikëlluese dhe ndjenjës së jo mirëqenies. Kjo mund të jetë shkas i hidhërimit ndaj vetvetes ose tjetrit, mos paraqitjes së zemërimit, mos suksesit ose zhgënjimit. Shpirtngushtësia është sëmundje vdekjeprurëse, e cila mund t'i shkaktojë dëm akut trupit ose dëm në bazë kronike si dhe mund të shkatërrojë pa kthim marrëdhëniet ndërnjerëzore. Gjatë gjendjes së shpirtngushtësisë, njerëzit mund të kenë edhe mendime vetëvrasëse. Shpirtngushtësia ndërtohet ngadalë, ndërsa zemërimi është manifestim akut, i cili nga brenda bren shpirtin dhe trupin njerëzor.

Ngandonjëherë shpirtngushtësia ose depresioni është pasojë e çrregullimit të baraspeshës kimike, sikurse te tërbimi, qoftë kur bëhet fjalë për gjendjen psikotrope me zvogëlimin e amineve të trurit, epinefrinës, norepinefrinës dhe dopaminës, ose çekuilibrimi hormonal sikur hipertireoza dhe sëmundja e Adisonit. Prandaj të gjitha rasteve të depresionit u duhet gjetur shkaku organik.

Mënyra e luftës kundër depresionit është fenomeni i kontrollit mendor. Duhet kuptuar se ne nuk jemi në gjendje të kontrollojmë fatin tonë. Lëshimet e caktuara dhe sprovat na dhurojnë mundësinë për të mësuar leksione të caktuara.

Ilaçi për depresion është shpresa. Allahu i Madhërishëm shpresën e përkrah duke thënë:

"O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së Allahut..." (Ez Zumer, 53)

Krahas me këtë, pa marrë parasysh shkallën e pashpresës, depresionin ose zhgënjimin, nuk duhet humbur shpresa, sepse gjithmonë drita është në fund të tunelit. Shpresa më e madhe është mëshira e Allahut.

Ne, myslimanët, besojmë se vuajtjet tona dhe fatkeqësitë janë sprova nga Allahu, i Cili ka thënë:

"Po ju menduat se do të hyni në Xhenet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush..." (El Bekare, 214)

"Ne do t'ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frutat, po ti jepu myzhde durimtarëve." (El Bekare, 155)

1 VIZITË NGA DELEGACIONI I BSHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti më datë 25. 08. 2020, një delegacion të Bashkësisë Islame të Kosovës, të kryesuar nga Kryeimami Sabri ef. Bajgora, së bashku me Drejtorin për veprimtari botuese z. Ramadan Shkodra, Zëvendësin e Kryeimamit Z. Fatmir Iljazi dhe z. Besim Mehmeti, Shef i kabinetit të Myftiut të Kosovës.

Kryetari Spahiu vlerësoi marrëdhëniet e ngushta vëllazërore dhe bashkëpunimin e afërt mes dy institucioneve islame në të mirë të besimtarëve dhe të mbarë shoqërisë shqiptare në dy anët e kufirit.

Gjatë takimit, ku ishin të pranishëm edhe Drejtori për Marrëdhëniet me Publikun dhe Median z. Agron Hoxha dhe Drejtori i Kulturës dhe Arsimit në KMSH z. Dorian Demetja, u diskutua edhe për disa projekte në fushën e botimeve, kulturës dhe prodhimeve të përbashkëta audio-vizive.

2 RESTAURIMI I XHAMISË SË QENDRËS SË PEQINIT, "ABDURRAHMAN PASHA"

Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, së bashku me Drejtorin e Vakf-Investimeve, z. Edison Hoti, Myftiun e Peqinit, z. Mensur Rrapanji, dhe Nënkryetaren e Shoqatës "Shtëpia e Bamirësisë", znj. Anisa Kita, përuruan restaurimin e xhamisë së qendrës së Peqinit, "Abdurrahman Pasha".

Në fjalën e tij hapëse Myftiu i Peqinit, z. Rrapanji pasi falënderoi donatorët dhe besimtarët që kontribuuan në restaurimin e xhamisë, u ndal në rëndësinë që ka mirëmbajtja dhe frekuentimi i saj nga besimtarët e zonës.

Ndërsa Nënkryetari i KMSH-së, z. Bica, u shpreh mjaft mirënjohës për kontribuuesit dhe theksoi se xhamitë janë vatra ku formohen qytetarë dhe individë me vlerë për shoqërinë.

Të pranishmit i përshëndeti gjithashtu edhe nënkryetarja e shoqatës "Shtëpia e Bamirësisë", znj. Kita, e cila vuri theksin në bashkëpunimin e mirë ndërmjet të gjithë faktorëve që çuan në restaurimin e plotë të kësaj xhamie.

3 SIMPOZIUMI NDËRKOMBËTAR (ONLINE) ME TEMË: "ROLI I INSTITUCIONEVE BAMIRËSE NË PROMOVIMIN E PAQES SOCIALE"

Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, në bashkëpunim me Këshillin Botëror të Komuniteteve Myslimane dhe Kolegjin Universitar "Bedër", zhvilluan më datë 27. 08. 2020, Simpoziumin Ndërkombëtar (Online) me temë: "Roli i Institucioneve Bamirëse në Promovimin e Paqes Sociale".

I zhvilluar nëpërmjet platformës online (zoom) ky simpozium mblodhi së bashku liderë fetarë, drejtues institucionesh, akademikë dhe besimtarë të shumtë nga vende të ndryshme të botës, veçojmë këtu folësin kryesor të këtij simpoziumi, H. E. Dr. Hamdan Almazrouei, Kryetar i Bordit të Drejtorëve, "Gjysmë Hëna e Kuqe e Emirateve të Bashkuara Arabe", Dr. Mohamed Beshari, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane, Kryetarin e Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, dhe Rektorin e Kolegjit Universitar "Bedër", Prof. Dr. Ferdinand Gjana.

Në fjalën e tij përshëndetëse kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, theksoi rolin e shoqatës "Gjysmë Hëna e Kuqe" në veçanti dhe të shtetit të Emirateve të Bashkuara Arabe në përgjithësi, për kontributin e tyre të vazhdueshëm në ruajtjen e paqes sociale nëpërmjet bamirësisë.

Më tej, ai ndau me të pranishmit kontributin ndër vite të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë në promovimin e harmonisë dhe bashkëjetesës ndërfetare në shoqëri si dhe ndihmën dhe solidaritetin ndaj njerëzve në nevojë.

4 KONFERENCA NDËRKOMBËTARE ME TEMË: "OBJEKTIVAT E LARTA TË PAQES NË ISLAM"

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, mori pjesë në Konferencën ndërkombëtare me temë: "Objektivat e larta të paqes në Islam", e organizuar online nga Këshilli Botëror i Komuniteteve Myslimane në Abu Dhabi.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin Dr. Ali Rashid al-Nuajmi, Kryetari i (KBKM), Dr. Muhamed Muhtar Xhuma, Ministri Egjiptian i Vakëfeve, Dr. Muhamed Matar al-Kaabi, Ministër i Çështjeve Islame dhe Vakëfeve në Emiratet e Bashkuara Arabe, personalitete dhe drejtues fetarë nga vende të ndryshme të botës.

Në fjalën e tij hapëse kryetari i konferencës, Dr. al-Nuajmi, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, u ndal në rëndësinë e trajtimit të tematikave të tilla me drejtuesit fetarë.

Pas fjalëve përshëndetëse, konferenca vijoi më tej me panelin e parë të referuesve, ku kryetari i KMSH-së, z. Spahiu, u përqendrua në faktorët ndikues të Islamit në paqen globale si dhe dobitë e saj në jetën e njeriut.

Më tej kryetari Spahiu u shpreh se ka ardhur koha që të qëndrojmë përkrah njerëzve dhe t'i orientojmë brezat e rinj drejt gjuhës së dialogut, mirëkuptimit dhe pranimit të njëri-tjetrit.

Konferenca vazhdoi më tej me panelet e tjera të referuesve, të cilët ndanë aspekte të ndryshme të temës me të pranishmit.

5 WORKSHOP ME TEMË: "ROLI I TOLERANCËS FETARE NË PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM"

Komiteti Shqiptar i Helsinkit zhvilloi më datë 08. 09. 2020, në ambientet e "Hotel Rogner", workshopin me temë: "Roli i Tolerancës Fetare në parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm".

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësuesit e komuniteteve fetare të vendit, ndër ta edhe Nënkryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, z. Taulant Bica, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë, z. Genti Kruja, Përfaqësuesja e Komitetit Shqiptar të Helsinkit njëkohësisht edhe moderatorja e këtij workshopi, znj. Miriam Neziri Angoni, përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, etj.

Në fjalën e saj hapëse, znj. Angoni, pasi falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, shtroi rëndësinë e organizimit të platformave të tilla në përpjekjen e vazhdueshme për të kultivuar më tej mirëkuptimin dhe dialogun e ndërsjellë ndërmjet komuniteteve fetare.

Ndërsa Nënkryetari i KMSH-së, z. Bica, në fjalën e tij përshëndetëse ndau me të pranishmit rëndësinë e bashkëpunimit në çrrënjosjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm nga çdo sferë e shoqërisë, duke i konsideruar këto fenomene si kërcënim për vlerat e larta morale e njerëzore.

Workshopi vijoi më tej me fjalën e të pranishmëve, të cilët prekën aspekte të ndryshme të temës në fjalë, duke nxjerrë kështu përfundime të vlefshme në ruajtjen dhe dërgimin më tej të misionit të përbashkët të harmonisë ndërfetare të vendit tonë.

Krijimi i bibliotekës personale

Dituria ngre njeriun. Padituria zhbën njeriun. Të diturit qëndrojnë në krye të hierarkisë njerëzore për shkak të diturisë dhe jo për pamjen, veshjen, pasurinë, pozitën shoqërore apo pushtetin. Ata i rezistojnë rrjedhës së kohës fizike. Nuk njohin plakje. As vdekje jo. Sa më shumë kohë fizike rrjedh, aq më të çmuar e të vyer bëhen. Madje çmohen e vlerësohen shumë më vonë nga çasti që kanë lënë këtë botë. Kanë ikur fizikisht, por gjurmët që kanë lënë pas nuk mund të shlyhen nga kujtesa njerëzore.

Hedhja në letër dhe ruajtja e saj është rruga kryesore që mundëson pasurimin e trashëgimisë së diturive nga një brezni te breznitë që vijnë pas. Bashkimi i fletëve të shkruara në një lidhje të vetme, jo vetëm fizike, të quajtur libër, është një nga arritjet e mëdha të njeriut, arritje që bëri të mundur ruajtjen e diturive të brezave të mëhershëm në gjendje shumë të mirë. Dituria e ruajtur përmes librave u grumbullua e u vendos në institucionet e bibliotekave. Biblioteka është vendi, ku librat e fushave të ndryshme të diturive qëndrojnë në pritje të atyre që dashurojnë kredhjen në thellësitë e detit të dijes. Bibliotekat janë kuvende të heshtura të mendjeve të ndritura të njerëzimit. E nëse gjendesh midis këtij kuvendi duhet të ndihesh më shumë se i nderuar.

Bibliotekat ofrojnë lehtësi për ata që duan të lexojnë e të studiojnë me akull të mendjes. Aty do të gjesh atë çka nuk mund ta sigurosh vetë personalisht në fushën e letrave. Shumë të tjerë në pamundësi për të siguruar çdo libër që duhet për studime i drejtohen bibliotekave si zgjidhja më e mirë. Por bibliotekat nuk mund të frekuentohen në çdo orar. Nëse dëshiron të kridhesh në thellësinë e natës në lexim biblioteka nuk ta mundëson këtë. Disa shërbime duhet t'ia krijosh vetvetes në rrjedhën e kohës. Një prej shërbimeve themelore është krijimi i bibliotekës personale.

Të jetosh në një vend ku sfida e të jetuarit me standarde është një ëndërr ankthioze nuk është e kollajtë të investosh në blerje librash dhe krijim të bibliotekës personale. Krijimi bibliotekës personale është i rëndësishëm, sepse që kur gdhihesh e derisa gjumi të mund në thellësinë e natës do të gjendesh përballë kuvendit të heshtur të mendjeve të ndritura që me heshtjen e tyre të cytin për t'u kredhur në faqet e librave. Në mungesë të bibliotekës personale do të të bëjnë shoqëri televizioni, smartphone dhe internet apo aktivitete të tjera me të cilat thjesht shtyn kohën si qëllim në vetvete. Biblioteka është antipod i tyre. Duam apo s'duam krijimi i saj mbetet një domosdoshmëri që të mos përfitojmë vetëm personalisht, por njëkohësisht të forcojmë dashurinë e pasardhësve për librin dhe leximin. Qëllimi themelor i krijimit të bibliotekës personale duhet të mbetet fuqizimi i vazhdueshëm i lidhjes me dijen, dhe shtim të librave sipas fushave të dijes mbi të cilat ke interes. Ndoshta pasardhësit nuk do të jenë të interesuar në të njëjtat fusha të dijes si ty, por do të mësojnë përmes shembullit tënd se njeriu që dëshiron të jetë mik i dijes nuk mund të jetojë i shkëputur prej librave.

Për të bërë punë të mira shpenzimi për të cilat vlen për breza të tërë njerëzish, duhet jo vetëm qëllimi i mirë dhe dëshira e madhe, por edhe mjetet financiare. Varfëria është një prej faktorëve kyç që pengon shumë individë të krijojnë bibliotekat personale. Sfida e sigurimit të mbijetesës mposht shumë ëndrra dhe dëshira për të ardhmen. Por sidoqoftë kemi plot raste e shembuj të njerëzve që shpenzojnë për të plotësuar dëshirat e tyre në sferën materiale, dhe nuk kujtohen asnjëherë të blejnë qoftë edhe disa libra përgjatë një viti. Mund të gjesh shtëpi luksoze dhe të mos kenë as edhe një libër brenda. Gjen njerëz që janë të gatshëm të shpenzojnë në blerjen e smartphone me çmime të kripura dhe iu duket shtrenjtë një libër. Shpenzojnë pa iu dridhur dora në festa, ahengje, për të ngrënë e për të pirë, për pushime disa herë në vit, e nuk marrin aspak mundimin për të shpenzuar në blerjen e librave. Kjo sjellje është tregues i qartë që moskrijimi i bibliotekave personale nuk pengohet vetëm nga varfëria ekonomike, por, më së shumti, nga varfëria kulturore që karakterizon edhe pjesën e pasur të shoqërisë.

Nëse kemi qëllimin e pastër për të shtuar dijen tonë, nuk ka faktorë që mund ta zhbëjnë krijimin dhe pasurimin e bibliotekave personale. Mund ta pengojnë apo frenojnë, por asgjë më shumë se sa kaq. Me sakrificë, pak sot e pak nesër, do të vijë dita kur biblioteka personale merr formë dhe përmbajtje. Bëhet pjesë e pandarë e jetës individuale dhe familjare si edhe pjesë e padiskutueshme e trashëgimisë shoqërore e kombëtare. Le të heqim dorë nga disa kënaqësi konsumatore të çastit dhe të investojmë për dijen, investim që nuk zhubroset, shprishet, vjetrohet, e humbet. Me krijimin dhe pasurimin e dalëngadaltë të bibliotekës personale, hedhim farat e së mirës në shoqërinë ku jetojmë, duke shpresuar se një ditë do të vilen frytet e kësaj pune, në mos prej nesh prej atyre që do të vijnë pas nesh.

| MSC. HAKI SAHITAJ |

Popullsia Myslimane SOT DHE NESËR

I. Hyrje

Është e vështirë të gjesh në historinë e njerëzimit një ngjarje, një ndodhi, një shpërngulje që të ketë qenë epiqendër ku janë ngulur rrënjët e një bashkësie; rrënjët e një shteti; rrënjët e një civilizimi; epiqendër të cilën akoma, si individë apo e tërë bashkësia, e merr për kriter se si e perceptojmë veten dhe botën përreth. Asnjë ngjarje s'ka qenë kaq e shtjelluar në përmasa dhe dimensione të gjëra si nga e kaluara si nga e tashmja. Është e vështirë të gjesh një ngjarje si Hixhreti, ku bashkësia myslimane për çdo vit shprish pluhurin e kohës për të kujtuar nga dhe si erdhëm deri këtu? Ku ishim? Ku jemi dhe për ku po shkojmë?

Si një ngjarje me një manifest kaq të gjerë - metafizik e historik - myslimanët kanë të drejtë ta lexojnë këtë histori në dimensione të ndryshme dhe të nxjerrin mësimet e nevojshme për jetën dhe kohën në të cilën jetojnë. Ne kemi vendosur që me rastin e këtij viti të ri hixhri të shkruajmë për prezencën e popullsisë myslimane. Jo për të bërë një krahasim apo përllogaritje përgjatë historisë, por si një aspekt, që krahas çështjeve për të cilat Hixhreti na bën të mendojmë dhe shkruajmë, siç janë besimi, dituria, Kur'ani, historia dhe rrethanat që shkaktuan hixhretin, urtësitë dhe mësimet e ndryshme. Ne shpresojmë se ky punim do ta bëjë më të plotë këtë reflektim drejt së ardhmes.

II. Vetëdija për sasinë

Jemi të vetëdijshëm se thelbi i çdo gjëje qëndron në cilësinë që gjërat mbajnë përbrenda dhe e jashtmja është manifestim i saj. Këtu nuk bën përjashtim as numri i popullsisë. Megjithatë, ne duhet të mos e neglizhojmë aspektin sasior të prezencës myslimane, pavarësish se fokusi qëndron te cilësia. Mendojmë se prezenca aktuale dhe ajo në të ardhmen mund të ndikoj pozitivisht në të gjitha aspektet, si në nivel të iniciativave personale po aq edhe në atë në nivele shtetërore apo të bashkësive. Ne duhet ta marrim shumë seriozisht dhe të kemi

parasysh faktin se sipas studimeve demografike numri i myslimanëve nëpër botë po rritet vërtet ndjeshëm. Kjo rritje duhet të na shtyjë të mendojmë shumë më seriozisht për prezencën e myslimanëve, për sfidat që na presin, për jetën dhe botën që duam të kemi. Cili do jetë roli ynë me një popullsi me rritje të lartë. Prezenca më e madhe nënkupton edhe sfida, kërkesa të reja, si do t'i përgjigjemi këtyre kërkesave?

Aktualisht, myslimanët janë i vetmi grup fetar që pritet të ketë rritje (në terma absolut dhe relativ) në dekadat e ardhshme. Madje këto studime na tregojnë se edhe numri aktual në fakt është më shumë se sa tregohet. Njëri aspekt ka të bëjë me shtete ku popullsia është popullsi myslimane dominuese dhe aspekti tjetër paraqet rritjen e kësaj popullate në vende si Evropa apo Amerika.

Këtu do të analizojmë disa nga shkaqet kryesore të kësaj rritje, sfidat dhe urgjencat me të cilat do mund të përballen në të ardhmen e afërt myslimanët, kudo që të jenë.

III. Pse po rritet popullata myslimane?

Në mes të shek. XX bota myslimane ka pësuar ndryshime dramatike nga ato njohëse, ideologjike, politike dhe demografike. Sot të flasësh për botën myslimane nuk do të thotë se po flasim vetëm për vendet e Afrikës Veriore ose ato të Azisë Juglindore, por edhe për një popullsi në rritje siç janë vendet Evropiane ose Sh. B. A-të. Sipas Pew Research Center deri në vitin 2010 janë llogaritur të jenë 1.6 miliardë myslimanë ose 23% e popullsisë globale. Aktualisht zona më e dendur është ajo në Indi dhe Pakistan (344 milionë). Por se sipas kësaj qendre ky numër po vazhdon të rritet me ritme të shpejta në Evropë dhe Sh. B. A . Në Kosovë myslimanët janë popullsi dominuese rreth 95.6% e popullsisë, në Shqipëri 56.7% dhe Maqedoninë e Veriut me 32.0%.

Në një studim që është bërë nga Sardar, Serra dhe Jordan janë treguar disa arsye pse po rritet me ritme të larta popullsia myslimane. Si arsye e parë është shënuar numri i lartë i lindjeve. Vlerësimet e fertilitetit në këto vende mund të variojnë nga 2.9 në 2.6 fëmijë për grua nga 2010 deri në 2015. Sipas të dhënave të KB, mesatarja globale për të njëjtin interval do të ishte 2.4, dhe kjo bie në 1.6 në vendet e zhvilluara. Si arsye e dytë vjen numri i lartë i rinisë. Më pas vjen përmirësimi i kushteve shëndetësore në vendet myslimane ku dhe shkalla e vdekshmërisë është ulur. Në dritën e përmirësimit të dukshëm të kushteve shëndetësore, nuk duhet të befasohet se shoqëritë myslimane mund të dëshmojnë rritje më të lartë të jetëgjatësisë. Në vitin 1990, jetëgjatësia myslimane ishte afro 62 vjeç në vendet me shumicë myslimane, por deri në vitin 2010, ajo ishte rritur tashmë në moshën 66 vjeç dhe parashikimet do të arrinin 73 vjet deri në 2030. Kjo rritje e popullsisë e në veçanti numri i lartë i rinisë myslimane e bën çështje më vete të menduarit se çfarë roli do luajë kjo popullatë(,) e në veçanti rinia dhe çfarë sfidash presin vendet myslimane.

IV. Skenarët e së ardhmes

Mendoj se fati i së ardhmes së myslimaneve nuk do jetë ndryshe nga fati i shumë popujve të tjerë nëse ne nuk do bëjmë hapa të rinj drejt vendimmarrjes globale. Rritja e popullsisë myslimane është edhe shpresë por edhe sfidë, që nuk do jetë e lehtë. Kjo do varet me çfarë vullneti dhe alternative do ofroj popullsia aktuale.

Kur një vendi i shtohet popullsia natyrshëm atë vend e presin sfida më të shumta. Kërkesat për edukim, punësim do jenë shumë më të larta dhe kjo mund të sjellë një rritje ekonomike ose në të kundërtën një krizë më të madhe papunësie. Nëse marrim parasysh skenarët me të cilat mund të përballet njerëzimi në tërësi, shohim se ndryshimet e shpejta teknologjike dhe investimet e larta në Inteligjencën Artificiale, na tregojnë se strukturat e ndryshme sociale do ndryshojnë me të madhe. Teknologjia do zëvendësojë shumë profesione të ndryshme, dhe kjo nxit ndryshime të mëdha në edukimin dhe aftësimin e njerëzve, që të mund të përballojnë trendet e reja të së ardhmes. Duke u bërë një popullsi me numrin më të madh, atëherë ata që do mund ta pësojnë më shumë do jenë pikërisht myslimanët. Nëse marrim parasysh kushtet që mund të kenë ose stilin e jetës perëndimore, vendet me popullsi myslimane në një të ardhme mund të shndërrohen dalëngadalë në popullsitë më të plakura. Kështu nivelet e larta të plakjes kërkojnë nevoja të veçanta në strukturat shëndetësore, ekonomike etj. Ndërsa rritja e rinisë tregon se fati apo rruga e këtyre vendeve do varet nga zgjedhja që do bëjë rinia. Për shembull, UNESCO ka vendet e Arabisë Saudite me 5660 studentë jashtë vendit, Iranin 4254, Nigerinë 3257, Pakistanin 2502, Bangladeshin 1614, Malajzinë 1224 dhe Marokun 1125, në njëzet vendet e saj të para për eksportues të studentëve jashtë vendit. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë në SH. B. A. bëri një studim për të parë se sa studentë nga jashtë, të cilët ndiqnin gradë në STEM, dëshironin të qëndronin në Shtetet e Bashkuara pas diplomimit. Ndërsa studentët aziatikë përbënin pjesën më të madhe të studentëve që studiojnë jashtë vendit në Amerikë, 64% e tyre dëshironin të qëndronin ashtu si edhe 7% e studentëve nga Lindja e Mesme. Arabia Saudite ishte një nga udhëheqësit në këtë

studim me 5.4% të studentëve të saj jashtë vendit që dëshirojnë të qëndrojnë në Shtetet e Bashkuara pas diplomimit.

Rritja e popullsisë myslimane po ashtu na tregon se aty ku myslimanët janë pakicë fetare shumë shpejt do bëhen komunitete më të madhe. Nëse në këto vende, si p.sh Evropë ose SH. B. A., problemi i islamofobisë apo terrorit do vazhdojë të shtohet, atëherë kjo mund të ndikojë në uljen e lindjeve, si shkak i frikës dhe natyrës së ambientit ose pjesëmarrjes më masive në aktivitete terroriste.

Varfëria e lartë në vendet myslimane, për më tepër ku në shumicën e vendeve myslimane papunësia e të rinjve (moshat 15 deri në 24 vjeç) është relativisht më e lartë se mesatarja globale, mund ta shtyjë dhe më tepër rininë në rrugë të gabuara. Për më tepër, myslimanët janë gjithashtu grupi fetar me popullsinë më të madhe rinore, gati 33% mesatarisht. Me fjalë të tjera, një në çdo tre myslimanë është më i ri se 15 vjeç. Kjo na bën me dije se edukimi mbetet në plan të parë si mjet për të vetëdijesuar popullsinë e re. Prandaj edukimi do mbetet sfida më esenciale e të gjitha shteteve apo bashkësive myslimane. Nëse kjo popullatë nuk merr një edukim të mirë, atëherë rritja e popullatës do thotë me tepër gjenerata të humbura, më tepër konflikte, më shumë emigrime, më tepër kriza identiteti fetare dhe kulturore.

V. Mozaiku i paqes dhe myslimanët

Rritja e popullatës myslimane nuk duhet parë si krenari përkundrejt popullsive të tjera, dhe kjo nuk duhet të merret si shkas për konflikte. Përkundrazi, ne këtu synojmë të jemi të vetëdijshëm për përgjegjësitë tona tani dhe nesër. Bota është lidhur jashtëzakonisht shumë, nga ushqimet që hamë, filmat që shikojmë, rrobat që veshim, edukimi që marrim, sfidat që po kalojmë janë të njëjtat kudo. Madje dhe sfida e këtyre ditëve me Virusin na tregon sa afër jemi bërë me vende, që deri para pak kohësh ishin botë të largëta, siç është Azia. Rritja e popullatës myslimane si tani por edhe në të ardhmen do jetë jetike për rolin dhe kontributin që do japim, në një botë me kriza nga më të ndryshmet. Po të shohim edhe takimin e fundit në Davos, ndër çështjet që ishin në fokus të botës, qëndrojnë sfidat klimatike, modelet e bizneseve, zhvillimet e mëdha teknologjike që po riformulojnë strukturat sociale, arsimore, sipërmarrjet, etj. Tani shumë intelektualë po sugjerojnë një aktivizim të përbashkët për fatin e jetës sonë në këtë botë. Dhe në gjeopolitikë nuk shikohet më si zgjidhje konkurrenca, por bashkëpunimi mes vendeve. "Ndërsa bota bëhet edhe më e ndërlidhur për sa i përket fluksit të informacionit, kapitalit dhe njerëzve, shtetet do të jenë më të varura nga njëra-tjetra për të realizuar rezultate pozitive për veten e tyre dhe komunitetin global.", shkruan kryetari i forumit B. Brende. Dhe myslimanët si popullsi në rritje jo vetëm që do duhet të bëjnë më shumë, por ne duhet të luajmë dhe rolin kryesor në promovimin dhe nxitjen e solidaritetit global për një botë më të mirë. Sido që do të duam ta shikojmë botën, kushdo që është i vetëdijshëm për mozaikun global e di që ky mozaik do mund të jetë më koherent vetëm me koherencën që myslimanët do mbajnë në vetëdijen e tyre se në fund të fundit ne jemi përgjegjës për fatin e njerëzimit dhe tërë botës së gjallë para Zotit. Fati ynë është i destinuar të jetë mënyra se si ne i shërbejmë njerëzimit dhe botës në emër të Tij.

VI. Përfundim

Në çdo kohë dhe vend të jesh i pakët në numër mund të sjellë jetë të vështirë, por edhe numri i lartë nuk zgjidh çdo gjë në vetvete. I Dërguari i Allahu na ka treguar se rritja e numrit mund t'i ngjajë shkumës së detit, pra që përsëri fati ynë do jetë i trishtueshëm nëse nuk do kemi një jetë në përputhje me besimin tonë. Në qoftë se nuk riorganizohet popullata e tanishme, nëse nuk do të punohet më shumë në infrastruktura më të mira edukative, nëse nuk merren parasysh sfidat e tanishme, në nivel shtetëror apo global, kjo rritje do sjellë vështirësi edhe më të madha. Ndoshta papunësi më shumë, përshkallëzim të terrorit, gjenerata të reja të tëhuajësuara. Të jemi më shumë do të thotë më shumë përgjegjësi ose më shumë vuajte. E ardhmja nuk është matematikë, që me statistika të parashikojmë të ardhmen, por ato na ndihmojnë të mendojmë për një alternativë dhe zbulojnë potencialin që kemi. Është në dorën tonë të zgjedhim se në çfarë drejtimi do na çojë krenaria e tanishme.

DISTANCA QË DUHET MBAJTUR NDËRMJET KËMBËVE (1)

Një pyetje që ndoshta vjen në mendjet e shumë njerëzve është: Si duhet të qëndroj në namaz? A duhet të qëndroj dhe këmbët e mia të jenë të hapura dhe të prekin këmbët e personit tjetër, apo duhet të qëndroj i qetë dhe të mos prek këmbët e personit tjetër, apo duhet të qëndroj me një hapësirë prej katër gishtash ndërmjet tyre siç bëjnë disa njerëz?

Pyetje të kësaj natyre kanë ngatërruar mendjet e shumë njerëzve, dhe ata do të donin që ta zbulonin metodën e saktë të traditës profetike duke qëndruar në namaz.

Në këtë kapitull do të përpiqemi t'u përgjigjemi këtyre pyetjeve dhe t'i ofrojmë lexuesit një pamje të qartë të qëndrimit korrekt të Sunetit. Duhet të kuptohet që në fillim se diskutimet për këtë temë nga dijetarët e Islamit janë shumë pak në krahasim me diskutimet e hollësishme që gjenden në çështjet e tjera të namazit.

Kështu, shumë pak informacion është gjetur në shumë libra të jurisprudencës lidhur me këtë çështje. Në fakt, madje edhe pikëpamjet e sakta të katër imamëve janë goxha të vështira për t'u përcaktuar.

Ekziston një numër hadithesh në lidhje me çështjen, që thekson rëndësinë e ruajtjes së rreshtave (safeve) të rregullt gjatë namazit. Këto transmetime janë zakonisht të shoqëruara me një paralajmërim nga i Dërguari i Allahut a.s. për pasojat e mosdrejtimit të rreshtave për namaz. Në një transmetim të tillë thuhet: "Drejtojini safet tuaja, ose përndryshe Allahu do krijojë përçarje mes zemrave tuaja."

Ka edhe transmetime tjera të cilat përmbajnë vërejtje të ngjashme. Kur një musal-li [personi që fal namaz] vëren që të tjerët hapin këmbët e tyre për të prekur këmbën e personit tjetër, ai nuk mund t'i shmanget, por pyet veten se nga është marrë një metodë e tillë.

Përkrahësit e këtij mendimi paraqesin një hadith në të cilin Sahabet i kanë bashkuar këmbët së bashku (d.m.th. secili ka bashkuar këmbët e tij me ato të personit pranë tij), pas marrjes së një vërejtje nga i Dërguari i Allahut a.s. për drejtimin e rreshtave. Ky hadith, edhe pse citohet si një provë në mbështetje të kësaj pikëpamjeje, në asnjë mënyrë nuk e bën bashkimin e këmbëve vaxhib [të detyrueshëm] siç pretendojnë mbështetësit e këtij opinioni.

Pjesët në vijim të këtij kapitulli do të punojnë për të sqaruar këtë pikë, duke parë diskutimin e mendime të ndryshme lidhur me çështjen e pozicionimit të këmbëve në namaz. Pas kësaj, hadithi i mësipërm do të analizohet në detaje dhe në mënyrë të pavarur në përpjekje që të sqarohet nënkuptimi i tij i vërtetë.

Për të formuar një rresht të rregullt, qoftë duke i bashkuar këmbët së bashku ose jo, është padyshim një nevojë shumë e rëndësishme për namazin me xhemat. Është gjithashtu përgjegjësi e imamit që të sigurohet se kjo është e bërë siç duhet para se të fillojë namazin. Megjithëse teknikisht dhe teorikisht drejtimi i rreshtave në mënyrë të përsosur nuk mund të klasifikohet si një pjesë përbërëse ose farz i namazit, padyshim që është një sunet i rëndësishëm për shkak të udhëzimeve strikte që janë dhënë për këtë nga i Dërguari i Allahut a.s.

Mendimet e ndryshme

Do të fillojmë duke cituar disa nga mendimet e shkollës juridike (medh'hebit) hanefi për mënyrën e mbajtjes së këmbëve në namaz. Në përgjithësi, vetëm dy duket të jenë mendimet dominuese që gjenden në tekstet e medh'hebit hanefi.

Mendimi i parë është që të lihet një hapësirë prej katër gishtërinjsh ndërmjet këmbëve të një personi, kur ai është në namaz. Ky mendim është gjetur në shpjegimin autoritativ të Imam Ibn Abidin, në librin "Ed-Durr el-Mukhtar" të Alame El-Haskefij, ku thotë: Hapësira që lihet ndërmjet këmbëve të një personi duhet të jetë e barabartë me atë të katër gishtërinjve të dorës, sepse kjo [hapësirë] është shumë efektive në paraqitjen e përulshmërisë dhe nënshtrimit [të kërkuar në namaz].

Lënia e një boshllëku të barabartë me katër gishta është cilësuar nga juristët [Fukahatë] si mendimi më i mirë, siç është provuar se, herë pas here, është mjaft i parehatshëm qëndrimi me këmbët e hapura (në namaz) për një periudhë të zgjatur kohore. Ky shqetësim e bën të vështirë edhe përqendrimin dhe shpesh rezulton në humbjen e vëmendjes dhe përkushtimit në namaz.

Mendimi i dytë, sipas shkollës

juridike Hanefi, mund të kuptohet nga argumentet e mëposhtme. Në librin "Mea'rif es-Sunen", një komentim i Sunenit të Tirmidhiut nga dijetari i hadithit 'Alame Jusuf El-Bennurij, thuhet se nuk përmendet në mesin e haditheve autentike përcaktimi i hapësirës ndërmjet këmbëve se si duhen mbajtur ato gjatë namazit.

Për këtë arsye, mund të konkludohet se suneti në pozicionimin e këmbëve në namaz është çfarëdo distance që dikush e sheh të përshtatshme dhe ndihet rehat teksa fal namazin.

Një hadith i transmetuar në Sunenin e Nesaiut, sqaron se Abdullah bin Mes'udi pa një person duke qëndruar në namaz me këmbët të bashkuara [d.m.th. preknin njëra-tjetrën] dhe gjykoi se ajo vepër është kundër sunetit. Ai e këshilloi personin

në fjalë, se nëse do të kishte praktikuar murauaha-n, do të kishte qenë më e preferueshme.

Fjala arabe murauaha zakonisht nënkupton mënyrën e qëndrimit në njërën këmbë dhe pastaj në tjetrën, duke alternuar ndërmjet tyre nëse lodhet njëra. Megjithatë, një tjetër kuptim i fjalës murauaha, është lënia e një boshllëku të vogël ndërmjet këmbëve dhe ky duket të jetë kuptimi më i mundshëm i kësaj fjale në lidhje me transmetimin e mësipërm, pasi personi po qëndronte me këmbët e tij të bashkuara. Nëse ne marrim kuptimin e dytë të termit murauaha, hadithi nënkupton se 'Abdullah bin Mes'udi r.a. e mësoi personin që të mbante një boshllëk të vogël ndërmjet këmbëve të tij, meqenëse suneti është që këmbët të mos bashkohen plotësisht bashkë (por as të mbahen shumë larg njëra-tjetrës).

Nga sa u përmend më sipër, mësojmë për fleksibilitetin e shkollës juridike Hanefi lidhur me këtë çështje. Për këtë arsye lejohet që një person të qëndrojë me hapësirën ndërmjet këmbëve të tij në mënyrë barabartë, ose më të madhe se gjerësia e katër gishtërinjve të dorës. Në përcaktimin e mendimit të

Shafi'ive në këtë çështje, një studim i kujdesshëm i literaturës së tyre tregon se mendimi i tyre më i njohur është se një person duhet të mbajë një boshllëk të barabartë me pëllëmbën e dorës ndërmjet këmbëve të tij. Megjithatë, në librin "El-Enuar", rekomandohet një tjetër tekst në fik'hun Shafi'i, se hapësira duhet të jetë vetëm katër gishta, ashtu siç edhe është një mendim i hanefive. Për më tepër, dijetari i madh Shafi'i, Imam En-Neueuij, del në përfundimin se:

Është e papëlqyeshme [mekruh] të bashkohen këmbët së bashku; dhe është e pëlqyeshme [mustehab] që të lihet pak distancë ndërmjet tyre.

Në total, tre janë mendimet e shkollës juridike Shafi'i:

1. Një hapësirë ekuivalente me pëllëmbën e dorës.
2. Një hapësirë sa katër gishta.
3. Aq hapësirë sa personi e gjykon të nevojshme.

Mendimi i parë është i posaçëm vetëm në medh'hebin Shafi'i, ndërsa dy mendimet e fundit janë të përbashkëta për dy shkollat juridike Shafi'i dhe Hanefi.

Dikush ndoshta e ka vënë re që tani, se asnjë nga mendimet (e mësipërme) nuk përmend se këmbët e një personi duhet të bashkohen me këmbët e personit ngjitur. Nëse me të vërtetë kjo do të ishte e saktë dhe mënyra e duhur e qëndrimit në namaz, ajo padyshim që do të ishte pranuar si e tillë.

| MEHMET DISHA |

Disa nga dobitë e dërgimit të *salavateve*

1. Përfitimi i dhjetë salavateve nga Allahu xh.sh. - thotë Profeti a.s.: "Kush më dërgon një salavat, Allahu atij i dërgon dhjetë salavate" (Buhariu).

2. Kthimi i salavatit prej Pejgamberit a.s. - "Nuk ka asnjë mysliman që më përshëndet me selam e që All-llahu të mos ma kthejë shpirtin për t'ia kthyer selamin". (Imam Ahmed, Ebu Davud).

3. Afërsia me Pejgamberin a.s. - "Vërtetë njeriu më i afërt me mua në Ditën e Gjykimit është personi që më së shumti më ka dërguar salavat".

4. Kushtëzohet pranimi i lutjes pas salavatit - Transmeton Aliu r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Nuk ka asnjë lutje që në mes saj e Qiellit nuk ka hixhab (pengesë) përderisa nuk dërgohet salavat mbi mua dhe vetëm pasi të dërgohet salavati ngrihet ajo pengesë". (Tirmidhiu).

5. Melaiket luten për ata që dërgojnë salavat - Muhamedi a.s. ka thënë: "Allahu ka krijuar një grup melaikesh, të cilët i urdhëron të kërkojnë vendtubime aty ku përmendet Allahu. Nëse gjejnë vende të tilla, ndalen pranë tyre, ku bëjnë amin në lutjet e besimtarëve të pranishëm, nëse ata dërgojnë salavat, melaiket së bashku me ta dërgojnë salavat, derisa besimtarët të shpërndahen, pastaj melaiket i thonë njëri tjetrit, lum për këta që po kthehen të falur prej Allahut".

6. Të fituarit e shefa'atit (ndërmjetësimit) të Muhamedit a.s. - "Kur të dëgjoni myezinin përsëritni ato që i thotë ai gjatë ezanit, pastaj dërgoni salavat në mua, pastaj prej Allahut kërkoni Vesilen për mua, pozitë që i jepet vetëm robit të Allahut, shpresoj se jam unë, prandaj kush kërkon vesilen për mua, më është lejuar t'i bëj shefa'at atij".

7. Përkujtimi për Pejgamberin a.s. - "Prej ditëve më të mira tuajat është dita e Xhumasë, në të cilën ditë u krijua Ademi a.s., në atë ditë edhe vdiq, atë ditë fryhet në Sur dhe atë ditë ngjan Kiameti, prandaj dërgoni shumë salavate atë ditë, sepse vërtet salavatet tuaja arrijnë tek unë".

8. Dërgimi i salavateve gjatë hyrjes në Xhami - Transmeton Ebu Hurejra r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Kur dikush të hyjë në xhami le të më përshëndesë me selam dhe le të thotë: 'O Allah më hap dyert e mëshirës Sate'". (Ibni Hibbani)

9. Salavati shkak i shpëtimit nga vështirësitë - Nga Sehl ibn Sad transmetohet të ketë thënë: "Erdhi një njeri te Pejgamberi a.s. duke iu ankuar për problemet e shumta jetësore, varfërinë e madhe dhe vështirësitë e ndryshme, atëherë Muhamedi a.s. i tha: "Kur të hysh në shtëpinë tënde jep selam, është dikush aty apo jo, pastaj më dërgo salavat mua dhe lexo Kul Huvallahu Ehad". Ky njeri filloi të vepronte në këtë mënyrë derisa gradualisht filloi t'i përmirësohet gjendja. Zoti ia shtoi pasurinë aq shumë saqë ai u shpërndante të afërmve dhe fqinjëve të tij.

10. Salavati në vend të dhënies së Sadakasë - Nga Ebi Seid r.a. transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: "Kur dikush nuk ka mundësi të japë sadaka, në lutjen e tij le të thotë: "Allahumme Sali ala Muhamedin abdike ue Resulike ue Sali alel Muminine uel Muminat uel Muslimine uel Muslimat". (O All-llah derdh bekimet mbi robin dhe të dërguarin Tënd - Muhamedin a.s., dhe mbi besimtarët dhe të nënshtruarit e Tu).

11. Përfitimi i mëshirës hyjnore - Nga Umer ibni Hattabi transmetohet se Muhamedi a.s. ka thënë: "Kushdo që ka marrë abdes le të thotë më pas: 'Eshhedu en la ilahe il-lall-llah ue enne Muhameden abduhu ue Resuluhu', pastaj le të më dërgojë salavat, sepse këtij besimtari do t'i hapen dyert e mëshirës së Zotit."

12. Të paraqiturit e salavatit te Pejgamberi a.s. - Nga Ebu Hurejra, Muhamedi a.s. ka thënë: "Kush më dërgon salavate pranë varrit tim e dëgjoj atë, ndërsa kush më dërgon salavat nga larg, unë e di atë.

Salavati mundëson të vështruarit e Resulit a.s.

Imam Esh-sharaniu thotë se Muhamedi a.s ka thënë: "Ai që thotë këtë salavat do të më shohë në ëndërr, dhe kush më sheh në ëndërr, do të më shohë në Ahiret, ku do të pijë nga uji i Keutherit dhe nuk do ta djegë zjarri." Ky salavat ka këtë përmbajtje: "Allahume Sali ala ruhi Muhamedin fil eruah ue ala xhesedihi fil exhsed ue ala kabrihi fil kubur ue ala alihi ue sahbihi exhmein."

Transmetohet në përmbledhjen e haditheve të Darekutnit që na jep edhe Imam Sujutiu r.a. në tefsirin e tij, se një ditë Hz. Ebu Bekri thotë: "Isha një ditë te Pejgamberi a.s. ku erdhi një burrë, i cili na dha selam, Pejgamberi a.s. ia ktheu selamin dhe e uli në afërsi. Pasi që përfundoi vizitën u ngrit dhe shkoi. Pejgamberi a.s. tha: "O Ebu Bekr këtij burri i ngrihen veprat e mira çdo ditë sa kanë vepra të mira gjithë banorët e tokës". Thashë: Po me ç'ka e ka arritur këtë? Pejgamberi m'u përgjigj: "Ai çdo herë në sabah më dërgon nga 10 salavate, ku çdo salavat është si salavati i të gjitha krijesave të tokës". E pyeta se cili është ai salavat?

I Dërguari a.s. mu përgjigj:

All-llahume Sal-li ala Muhammedin nebij adede men sal-la alejhi min halkike ue Sal-li ala Muhammedin nebij kema jenbegi lena en nusal-lijje alejhi ue Sal-li ala Muhammedin nebij kema emertena en nusal-lije alejhi. (O All-llah, derdhi bekimet mbi Profetin Muhamed a.s. aq sa krijesat Tua bien në salavate mbi të, ashtu siç na takon neve që ta përshëndesim atë dhe ashtu siç na obligove të dërgojmë salavate mbi të).

Zoti ynë

Mos lejo që zemrat tona të devijojnë tani, pasi na ke udhëzuar. Por na dhuro mëshirë prej pranisë Tënde, sepse Ti je dhuruesi më i madh.
Zoti ynë i Madh, ne vetëm Ty të besuam, e vetëm tek Ty mbështetemi. T'u drejtuam ty me tërë fuqinë e shpirtit, dhe e dimë që në fund, përballë Teje do të vijmë.
Zoti ynë i Lartësuar, mos na lër ne vetëm për vetëm me sprovën e mo huesve! Na fal neve, sepse padyshim që Ti je i Shenjtë e i Urtë.
Zoti ynë, mos na dëno nëse harrojmë ose gabojmë. Zoti ynë, mos na ngarko neve ngarkesa si iu ngarkove atyre para nesh. Zoti ynë, mos na ngarko mbi atë që ne kemi forcë të mbajmë.
Zoti ynë, ne i kemi bërë padrejtësi vetes. Nëse Ti nuk na fal dhe mëshiron, me siguri do të jemi prej të humburve.
Ne jemi të padrejtë, të rrënuar dhe të shkatërruar. Si myslimanë kurrë në histori nuk kemi qenë kaq larg Teje. Kurrë nuk kemi hyrë në thellësi të tilla të dështimit. Kurrë nuk kemi qenë kaq "pa Ty". Na dërgo një fllad shprese prej mëshirës Tënde. Na e ndrysho këtë gjendje mjerimi.
O strehë Burimi për të mjerët, O posedues i ilaçit për të sëmurët dhe udhëzues i qartë për të humburit! Ne të braktisëm Ty dhe u dalldisëm drejt botës. Gjatë kësaj kohe askush nuk i hapi dyert për ne. Mendimet tona u quajtën krime, ndjenjat tona u përbuzën dhe u përqeshën, veprimet tona u dënuan deri sa ne të kuptojmë se s'ka strehë tjetër veç derës së Mëshirës Tënde.
Por, Zoti ynë! Ne e dimë që deri më tani, asnjë nga ata që kanë pritur pranë derës Tënde nuk janë kthyer duarbosh, por janë kthyer prej aty me bekim prej Teje, të falur, të mëshiruar, të udhëzuar e plot shpresë. Prandaj të kërkojmë me përgjërim: hapi portat e faljes dhe mëshirës.
Dërgo një dritë nga prania Jote për ata që vuajnë në errësirë, sidomos këto ditë, kur rrethanat sociale janë në çrregullim të plotë; kur zërat e tiranëve dëgjohen kudo. Shuaj zjarrin e tiranisë dhe padrejtësisë me fuqinë tënde të pafund. Na jep një ilaç për të gjitha fatkeqësitë që kemi vuajtur për shekuj me radhë. O më i Mëshirshmi, Më i Dhembshuri, pranoji lutjet tona!
O Zot i Mëshirës dhe Faljes, forcoji zemrat tona në fe. Mbushi zemrat me besim. Udhëzona ne, familjet tona, shoqërinë tonë! O i Dashur, dhurues i dashurisë, furnizoji zemrat tona me dashuri e mëshirë! Pastroji zemrat tona nga urrejtja, smira, xhelozia, armiqësia dhe çdo e keqe.
O Zot, dhuroi vendit tonë paqe, begati e mirësi dhe mbroje nga çdo rrezik e fatkeqësi...
O Zot, dhuroji botës paqe e qetësi.
Zoti ynë, nga zemërimi Yt kërkoj strehim në kënaqësinë tënde, nga dënimi Yt kërkoj strehim në faljen Tënde. Prej Teje kërkoj strehim tek Ti. Po t'i numëroj të gjitha lavdërimet nuk do të mund t'i përfundoj. Ti je ashtu siç e ke cilësuar/lavdëruar veten.

Lutje

O Zot i madhërishëm; Krijues i të gjithë botëve, burim dhe mbajtës i jetës, Zot i të gjithë atyre që dihen e që nuk dihen, i atyre që merren e që nuk merren me mend, paç lavdi dhe të qofshim falë.
O Zot i gjithëfuqishëm, na ndihmo që të jemi ashtu si duhet të jetë çdo mysliman i vërtetë; të besueshëm, të drejtë, të mëshirshëm, të virtytshëm, të arsimuar dhe të vyer.
O Zot i gjithëmëshirshëm, le të mbretërojë midis nesh barazia dhe vëllazërimi, pa marrë parasysh racën, origjinën dhe kombësinë, ashtu sikur ke thënë dhe ke urdhëruar Ti.
O Zot i gjithëmbarshëm, le të jenë mendimet tona të pastra dhe përparimtare, duart tona le të punojnë me nder, sytë tanë le të shikojnë haptas dhe me nder, fjalët tona le të jenë të vërteta dhe të drejta.
O Zot i mëshirshëm, ndihmona që jetën e kësaj bote ta përputhim me të vërtetën madhështore të Kur'anit; ndihmona që fëmijët tanë t'i nxjerrim në rrugë të mbarë dhe t'i edukojmë në të vërtetat islame, sepse para Teje jemi përgjegjës për ta!
O Zot i madh,
Na i mbush zemrat me shumë dashuri!
Na jep shumë sukses!
Na fal një jetë të lumtur!
Na bëj dhe na rretho me njerëz që na duan!
Bëje fundin e jetës sonë sa më të këndshëm!
Na bëj banorë të Parajsës së amshuar, neve, familjet tona dhe të gjithë miqtë e dashamirët!

| IMAM VEHBI ISMAILI |

POROSI MADHËSHTORE në Kur'an

"Dhe plotësoni masën e peshoni me drejtësi."

Kjo porosi përfshin dy çështje: 1. Plotësimin e masës; 2. Peshimin me drejtësi. Ajo lufton një ves shumë të keq, lakminë për të shtënë në dorë atë që nuk është e jotja dhe nuk ke të drejtë ta bësh tënden.

Kur jep në masë më pak sesa paguhet dhe kur peshon mangët, do të thotë se ke bërë vjedhje të fshehtë. Nëse përvetësimi i pasurisë së jetimit, ndodh ngaqë ai vetë nuk është në gjendje ta kontrollojë dhe ta administrojë atë e dëmtohet vetëm ai, mosplotësimi i masës dhe padrejtësia në peshim dëmton mbarë bashkësinë, sepse është e domosdoshme që njerëzit të blejnë e të shesin; pa këto marrëdhënie asnjë bashkësi nuk mund të jetojë; tregtinë e kërkon çdo bashkësi; nëpërmjet saj këmbehen mallrat, bëhet shitblerja e tyre. E kjo gjë bëhet me masë e me peshë. Prandaj, profesioni i tregtarit është lavdëruar nga Zoti, se, më një anë, fiton me djersën e tij jetesën dhe mban familjen e tij; në anën tjetër me mjeshtërinë e vet i shërben bashkësisë, se merr pjesë në zhvillimin e përparimin e saj.

Por, fatkeqësisht, gjithmonë ka pasur e ka edhe sot asisoj njerëzish, të cilët lakmia për të bërë sa më shumë pasuri, i shtyn që të përdorin edhe mënyra e mjete të pandershme. Këta lloj njerëzish humbin vlerën e tyre para Zotit e para të tjerëve dhe pasuria e vënë në një mënyrë të tillë nuk u ka bereqet. Tregtarë të tillë përdorin mënyra të ndryshme për ta vjedhur njerëzinë; përveç matjes dhe peshimit të mangët, përdorin dhe mashtrime të tjera: e paraqesin si të mirë mallin që ka të meta, kërkojnë çmime më të larta se ç'vlen sendi që shitet, ngaqë shfrytëzojnë nevojën e blerësit për të, etj. Por mjeti më i vjetër dhe më i përdorur nga tregtarët e panderë ka qenë dhe është matja e peshimi më i mangët. Kur'ani i Shenjtë na tregon shembullin e disa popujve, të cilët e kishin bërë zakon këtë ves. Zoti u kishte dërguar Profetë atyre, të cilët, pas ftesës për adhurimin e një Zoti, u kërkonin atyre që të plotësonin masën dhe të peshonin me drejtësi. Ja si thuhet në Kur'an: "Dhe në popullin e Medjenit dërguam Shuajbin, vëllanë e tyre, i cili u tha: 'Adhuroni Zotin, ju nuk keni zot tjetër veç Atij. Dhe matni e peshoni me drejtësi, mos ia jepni njerëzisë mangët gjërat e tyre dhe mos shkaktoni ngatërresa në tokë, duke qenë ajo në rregull! Kjo është më e mira për ju, po të jeni besimtarë.'" (7:85)

Ata nuk ua vunë veshin udhëzimeve të Shuajbit, që ishte vëllai i tyre, por vijuan udhën e shtrembër e u shpaguan me dënim të rreptë. Për këtë Kur'ani thotë: "Dhe kur erdhi vendimi Ynë, Ne me mëshirën Tonë i shpëtuam Shuajbin dhe ata që kishin besuar, ndërsa ata që ishin mizorë, i përlau një britmë (e tmerrshme) dhe u bënë kufoma (të vdekur) në banesat e tyre, sikur mos të kishin jetuar kurrë. Le të jetë larg (nga mëshira e Zotit) Medjeni, ashtu siç ka qenë larg edhe Themudi!" (11:94-95)

Njerëzit janë njerëz në çdo komb dhe në çdo kohë. Lakmia e madhe ka qenë, është dhe do të jetë gjithmonë dëmshme. Është fakt se njerëzimi ende nuk ka shpëtuar nga njerëz të tillë, prandaj revelata hyjnore e urren këtë ves e këtë sëmundje, e përmend dhe e ndalon edhe në kumtimin e fundit – në Kur'an.

Kur'ani na e ndalon matjen dhe peshimin e mangët dhe ky ndalim vjen menjëherë pas porosisë që "Të mos i afrohemi pasurisë së jetimit, veç për të mirë!", sepse në

të dy rastet kemi të bëjmë me përvetësim, me vjedhje dhe plaçkitje të urryera nga Zoti dhe nga njerëzit e ndershëm.

Në këtë verset përmendet edhe fraza: "Ne askënd nuk ngarkojmë më tepër seç ka fuqi." Besojmë se qëllimi i saj mund të jetë për të ngritur përgjegjësinë e tregtarit, që mat ose peshon keq nga përgjegjësia e atij, që nuk ka dijeni për matje e peshime të mangëta, kur masa ose pesha është fabrikuar gabimisht. Kjo do të thotë, gjithashtu se njeriu duhet të ruhet brenda mundësive të tija, dhe kur ta kuptojë se masa ose pesha ka të meta duhet t'i ndreqë menjëherë. Kjo porosi nuk erdhi vetëm në suren "El-En'am", në të cilën përmenden edhe nëntë porositë e tjera. Kaq shumë e lufton dhe e urren Zoti këtë ves të ligë, saqë një prej sureve të Kur'anit e ka titulluar "El-Mutaffifijn - Ata që nuk masin drejtë".

Në të përmendet gjendja shpirtërore e mashtruesve në këmbim të mallrave dhe ndëshkimi që i kërcënon në jetën tjetër: "Mjerë (për) ata që masin metë, kur masin për vete e plotësojnë, por kur masin ose peshojnë për të tjerët, u japin më pak. A nuk mendojnë ata se do të ringjallen (e do të japin llogari) në Ditën e Madhe, kur njerëzit do të qëndrojnë para Zotit të gjithësisë?" (83: 1-6)

Ligjvënësit myslimanë, duke u mbështetur në këto versete, të cilët e quajnë mëkat dhënien më pak sesa paguhet, qoftë në masë, qoftë në peshim, fusin në këtë grup të gjithë ata që u japin njerëzve më pak se ç'duhet, si dhe çdo njeri, i cili nuk e kryen si duhet detyrën që ka marrë përsipër. Për shembull, kur angazhohesh e paguhesh për të punuar tri orë, duhet ta plotësosh punën e tri orëve. Kontraktuesi që ndërmerr për të ndërtuar një shtëpi duhet të shtjerë në përdorim lëndën, të cilën e ka marrë në kontratë e jo të vërë në të material më të dobët. Nëpunësi, qoftë privat, qoftë shtetëror, duhet ta kryejë pa vonesë detyrën që ka marrë përsipër dhe të mos i përcjellë njerëzit me sot e me nesër. Dëmi që i vjen bashkësisë njerëzore nga dhënia më pak e disa gramëve në kilogram djathë ose disa centimetrave më pak në një metër nuk është më i madh se i atij që ndërton një ndërtesë me lëndë të dobët, e cila mund të shembet e të shkaktojë edhe vrasje njerëzish; e një lloji është edhe puna e atij nëpunësi shtetëror, i cili i mundon njerëzit për të kryer çka kërkohet prej tij, duke u thënë eja nesër, ose eja pasnesër, kur ka mundësi ta bëjë punën e tij sa më drejtë dhe sa më shpejt e të mos mungojë në detyrë; ndryshe bën mëkat dhe është përgjegjës para Zotit, sepse nuk e ka kryer si duhet detyrën e vet.

QERIM HAXHIU

TEOLOG, MËSUES DHE VEPRIMTAR I SHQUAR NË DIASPORËN E SHQIPTARËVE TË EGJIPTIT PËR ÇËSHTJEN KOMBËTARE SHQIPTARE

Qerim Haxhiu lindi në Lushnjë më 7 shkurt 1920 në një familje qytetare, fisnike, patriotike të Lushnjës. Djali i patriotit të shquar shqiptar Bajram bej Haxhiu(,) i cili ishte një nga anëtarët e Komisionit Nismëtar të Thirrjes dhe Organizimit të Kongresit të Lushnjës dhe i vëllai i legjendës së sportit shqiptar Abdurrahman Roza Haxhiu. Qerimi shkollën fillore e kreu në Lushnjë(,) ndërsa shkollën e mesme e kreu në Medresenë e Tiranës. Qerim Haxhiu shkollën e lartë e vazhdoi për teologji (shkenca islame) në universitetin "Al-Azhar" në Kajro, Egjipt.

Ai në vitet '30 u aktivizua si futbollist me ekipin e futbollit "Kongresi i Lushnjës" i qytetit të Lushnjës. Qerimi ishte një nga futbollistët e gjeneratës së parë të ekipit lushnjar dhe i pari që nisi "rrugën" e gjatë të mbiemrit që bëri histori në sportin lushnjar dhe atë shqiptar "Haxhiu".

Në vjeshtën e vitit 1938 Qerimi u nis nga Lushnja me tranzit në Selanik dhe mbërriti në Aleksandri. Kjo rrugë e gjatë për Qerimin ishte e paharruar për faktin se për të ishte rrugë pa kthim mbrapa në atdhe gjersa ndërroi jetë, por në vitin 1967 arriti të merrte një leje për vizitë në atdhe. Patrioti Qerim Haxhiu fizikisht ishte në Egjipt, por me shpirt e zemër ishte gjithmonë në Shqipërinë Etnike. Ai botonte gjithnjë artikuj për atdheun, Shqipërinë, dhe çështjen kombëtare në gazeta, revista të diasporës shqiptare të Egjiptit, gjithashtu ka shkruar dhe poezi nga më të ndryshmet.

Haxhiu ka qenë nismëtar i shumë organizimeve si dhe hartues i disa memorandumeve, peticioneve të gjitha këto për çështjen kombëtare shqiptare. Më 7 prill 1939, kundër okupimit të Shqipërisë nga Italia fashiste(,) Qerimi hartoi një peticion si dhe ishte njëri prej studentëve shqiptarë organizatorë të protestave në Kajro. Në vitin 1958 Tito do të vizitonte Naserin në Egjipt dhe këtij të fundit Qerimi i nisi një memorandum rreth 20 faqe për gjendjen e shqiptarëve në Jugosllavi. Në përmbajtjen e Memorandumit jepeshin të dhëna mbi golgotën e shqiptarëve në Jugosllavi dhe shpjegohej se myslimanët nuk jetojnë vetëm në Bosnje, por edhe në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e gjetiu dhe se me kombësi ata janë shqiptarë. Memorandumi megjithëse iu drejtua Naserit nuk u protokollua në zyrat e Institucionit të Presidentit të Egjiptit por memorandumi u dorëzua në Ambasadën Jugosllave. Kjo bëri që atdhetari Qerim Haxhiu të arrestohej gjithmonë përkohësisht kur Tito do të vizitonte Egjiptin.

Në 9 korrik 1941 Qerimi do të shkruante poezinë "Teqeja Magauri" kushtuar teqesë bektashiane shqiptare të Baba Ahmet Serri Glina me origjinë nga Përmeti. Teqeja "Magauri" në Kajro të Egjiptit u kthye në një "shtëpi" për shqiptarët atje pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia Fashiste. Qerim Haxhiu ishte një besimtar mysliman i devotshëm dhe kurrë nuk u largua nga leximi i Librit të Shenjtë, Kur'anit, dhe nga falja e namazit. Haxhiu ishte ndër personalitetet e njohura shqiptare që emigruan në Egjipt. Ai ishte atdhetar i paepur për çështjen kombëtare shqiptare në Koloninë e Shqiptarëve të Egjiptit dhe gjithë jetën dhe veprimtarinë patriotike ia kushtoi atdheut, Shqipërisë, Kosovës, shqiptarëve të Malit të Zi, Maqedonisë dhe Çamërisë.

Qerimi kishte njohuri të thella për historinë shqiptare dhe gjithnjë fliste për Rilindësit e gazetat që ata botuan, të cilët kontribuuan në zgjimin dhe ndërgjegjësimin kombëtar të shqiptarëve të Egjiptit. Haxhiu ishte antikomunist i flaktë, demokrat dhe nacionalist i madh. Për regjimin diktatorial komunist në Shqipëri patrioti Qerim Haxhiu ka thënë se:

"Regjimi komunist në vend që rinisë t'ia shtojë dashurinë për atdheun, regjimi komunist u interesua për Rusinë dhe Vietnamin, për dallim nga rinia kosovare, e cila ndjenjën e atdhedashurisë e ruajti më tepër. Mirëpo, rinia kosovare nuk e dinte se Shqipëria zyrtare më tepër interesohej për Vietnamin se sa për Kosovën."

Në 21 vjetorin e ndarjes nga jeta të Andon Zako Çajupit (11 korrik 1930-11 korrik 1951),Qerimi mbajti një fjalim mbi jetën dhe veprën e Çajupit, gjatë homazheve që zhvilluan atdhetarët e kolonisë shqiptare të Egjiptit, në varrin e Andon Zako Çajupit në Egjipt. Nga të gjithë veprimtarët e Kolonisë Shqiptare të Egjiptit Qerim Haxhiu ishte i vetmi që shkroi një përmbledhje (histori) për diasporën shqiptare të Egjiptit, që i duhej Federatës Pan-Shqiptare "Vatra" në Amerikë. Patrioti Qerim Haxhiu ka mbajtur lidhje të vazhdueshme në të gjallë të tij me Federatën Pan-Shqiptare të Amerikës

"VATRA" dhe ishte i abonuar në Gazetën "DIELLI". Gjithashtu Qerimi ka bashkëpunuar me Drejtuesit e Vatrës edhe në një projekt historik të Diasporës Shqiptare në Egjipt, projekt që e ndërmori "VATRA" dhe që u realizua nga Qerim Haxhiu në bashkëpunim me studentët shqiptarë në Egjipt.

Qerimi edhe në Egjipt gjatë gjithë jetës qëndroi pranë shqiptarëve dhe për këtë është shprehur:

"Unë kudo që të shkoj, kërkoj shqiptarë, sepse pa ta dita nuk më shkon."

Qerimi ka takuar edhe Mbretin e Egjiptit me origjinë shqiptare Faruk njëherë në një iftar që mbreti organizoi për studentët dhe njëherë tjetër në Bashkësinë Shqiptare. Ai në Kajro ka takuar edhe personalitete të rëndësishëm shqiptarë, ndër të cilët përmendim: Mbreti Zog I dhe Familja Mbretërore Shqiptare (Mbretëreshën Geraldina, Princin Leka I, Skënder Zogu), Ernest Koliqi, Abaz Kupi, Nexhmedin Qorraliu, Qemal Butka, Aleksandër Meksi, etj.

Gjatë qëndrimit të Familjes Mbretërore Shqiptare në Aleksandri, Qerimi mbajti lidhje miqësore dhe kjo ishte vazhdimësi e një miqësie të vjetër që fillesat i ka ose në vitin 1920 në Kongresin e Lushnjës mes babait të Qerimit, nismëtarit të Kongresit, Bajram Haxhiu, me delegatin e Matit Ahmet Zogun. Haxhiu e vizitonte shpesh Familjen Mbretërore Shqiptare në rezidencën e saj në Aleksandri. Gjithashtu gjatë stinës së verës Qerimi qëndronte në rezidencën e Familjes Mbretërore Shqiptare, ku i mësonte dhe gjuhën arabe (lexim dhe shkrim) mbesave të Mbretit Zog. Qerimi kishte miqësi edhe me Abaz Kupin dhe me djalin e tij që ishin moshatarë dhe shokë të ngushtë.

Haxhiu ka kontribuar vullnetarisht në mësimin e gjuhës shqipe te fëmijët e shqiptarëve në Kajro. Gjithashtu ai ka dhënë edhe leksione 3 herë në javë për studentët shqiptarë në Liceun e Kajros.

Në vitin 1967 gati pas 3 dekadash u nis me anë të një vize (pasi kapërceu pengesa të shumta burokratike të regjimit diktatorial komunist) për të vizituar për herë të parë atdheun(,) Shqipërinë(,) që pas vajtjes me studime në Egjipt më 1938. Kjo do të ishte vizita e parë dhe e fundit në atdhe, ndaj dhe e kujtoi gjatë gjithë jetës së tij aktivisti i shquar për çështjen kombëtare shqiptare Qerim Haxhiu. Një moment prekës të kësaj vizite atdhetari Qerim Haxhiu nuk e harroi asnjëherë për të cilin ka treguar se:

" Nga Tirana deri në Lushnjë nuk kam pushuar së qari. Kur arrita në Lushnjë oborri i shtëpisë ishte mbushur me njerëz. U takova me të gjithë me shumë mall. Kur hyra në dhomë, në të cilën po rrinte babai (Bajram Haxhiu), ai posa më pa thirri: Qerim! Dhe i ra të fikët! Nuk kishte faj ngase kishte njëzet e nëntë vjet pa më parë! Këto janë përshtypjet e kësaj dite që nuk do t'i harroj kurrë."

Qerim Haxhiu ishte i martuar me znj. Shukrane me origjinë nga Prishtina por me vendbanim në Kajro,vajza e Dr. Shyqyri Çupishti, i cili ishte kirurg dhe Drejtor në Spitalin e Vlorës në vitet 1933-1935. Qerimi ka lënë dy fëmijë, një djalë dhe një vajzë. Djali, Iliri, me profesion farmacist, punon në fabrikën e ilaçeve në Stamboll të Turqisë, ndërsa vajza Dhurata, Doktore e Shkencave të Kimisë, Profesoreshë në Universitetin Koç të Turqisë. Iliri i ndoqi studimet në Universitetin e Kajros, ndërsa Dhurata në atë Amerikan. Fëmijët e tij jo vetëm që e flasin gjuhën shqipe, të cilën ua mësoi i ati, qartë e rrjedhshëm, por

ata njohin edhe disa gjuhë të huaja.

Shtëpia e patriotit Qerim Haxhiu në lagjen "Abidinë", në rrugën "Sherif Pasha El Kebir nr. 2", në Kajro ishte një mjedis totalisht shqiptar në tokë të huaj. Biblioteka e Qerim Haxhiut ishte burim dijesh dhe e njohur nga të gjithë ata të cilët (kryesisht studentët shqiptarë me studime në Kajro, me origjinë nga Shqipëria, Kosova, shqiptarë të Malit të Zi, Maqedonisë dhe Çamërisë) e kishin vizituar patriotin dhe kishin lexuar libra nga biblioteka e tij apo edhe ishin këshilluar me të për çështjet atdhetare. Biblioteka përbëhej nga një literaturë e çdo lloji dhe e zgjedhur në disa gjuhë si: shqip, turqisht, italisht, anglisht, frëngjisht, etj. Librat kryesorë në bibliotekën e atdhetarit të shquar Haxhiu ishin ata që tregonin për historinë e Shqipërisë dhe për çështjen kombëtare shqiptare. Në disa prej rafteve të bibliotekës së madhe të Qerimit qëndronin pothuajse të gjithë librat e shkruar nga autori i preferuar i tij, i cili ishte "Homeri Shqiptar", Gjergj Fishta. Librat e Fishtës e kthenin shpeshherë me mendje e zemër në atdhe por pa harruar edhe pikturat e veçanta, për të ato të piktorit korçar Guri Madhi, që pasqyronin atdheun që Qerimi aq shumë e donte dhe kishte kontribuar pamasë për çështjen e tij.

Qerim Haxhiu ditët e pleqërisë i kaloi duke punuar paradite në fabrikë (edhe pse kishte dalë në pension), kurse pasdite duke lexuar, e herë-herë duke vizituar ndonjë familje shqiptare. Qerim Haxhiu ka kontribuar në fillim të viteve '90 në përpilimin e librit "Shqiptarët e Egjiptit" me informacionet e tij të shumta për Historinë e Diasporës Shqiptare të Egjiptit.

Qerim Haxhiu, me pak fjalë, ishte erudit por që nuk arriti dot të jepte kontributin e tij në Shqipëri, sepse në atë kohë regjimi diktatorial-komunist personaliteteve intelektuale të arsimuar jashtë, si atdhetari Qerim Haxhiu, nuk ua hapi "derën" për të kontribuar në atdhe, në Shqipëri. Megjithatë ai e vazhdoi në Egjipt veprimtarinë e tij patriotike me kontributin e madh për çështjen kombëtare shqiptare. Emri Qerim Haxhiu është shënuar me shkronja të arta në historinë e Kolonisë Shqiptare të Egjiptit. Ai ishte Rilindësi i Fundit në Koloninë e Shqiptarëve të Egjiptit. Qerim Haxhiu u nda nga jeta më 1 janar të vitit 2003.

Për Qerim Haxhiun janë shkruar disa faqe në librin "Shqiptarët e Egjiptit" të autorit Emin Azemi – Shkëlzen Halimi, botuar në Shkup, në vitin 1993 nga shtëpia botuese Logos-A. Në Gazetën Illyria, numër 1209, 21-23 janar 2003 është botuar një artikull nga Prof. Beqir Ismaili me titull "U largua nga kjo jetë edhe një veprimtar i diasporës shqiptare: Qerim Haxhiu (1920-2003)". Në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "Roli i Mërgatës në Shtetformim", Prizren, 10-13 qershor 2012 e organizuar nga Ministria e Diasporës Kosovë me rastin e 100-vjetorit të Shtetit Shqiptar është publikuar një shkrim për atdhetarin e madh Qerim Haxhiu.

Në vitin e 100 vjetorit të lindjes së atdhetarit (1920-2020), Këshilli Bashkiak Lushnjë me Vendimin me Nr. 67 Datë 28/07/2020 vendosi të vlerësojë me titullin "QYTETAR NDERI I LUSHNJËS" Z. Qerim Haxhiu (pas vdekjes) me motivacionin: "Bir i një familjeje shumë të njohur lushnjare, zoti QERIM HAXHIU, mbetet një atdhetar i madh midis diasporës shqiptare në botë. Në Egjiptin e largët, ku jetoi e punoi për gati 60 vite, ai krijoi një Lushnjë e Shqipëri të vogël, bëri gjithçka për mësimin dhe përhapjen e gjuhës sonë të lashtë dhe lartësoi vlerat e bukura morale e kulturore të vendit tonë".

ÇDO NJERI NË BRENDËSI E KA TREGIMIN E VET TË PIKËLLIMIT

Çdo njeri, thellë në brendësi, e ka tregimin e vet të pikëllimit.

Njeri, që në brendësi fsheh gjynahe e prej tyre do të pendohet.

Njeri, që ndërgjegjja e tij ndien dhembje nga gjynahu i bërë.

Njeri, që në brendësinë e tij ka frikë nga vetmia dhe nga e panjohura.

Njeri, që ka vuajtur nga ata që i ka dashuruar, apo vuan për ata që i do.

Njeri, që nuk mundet ta paraqesë humanitetin e tij të vërtetë.

Njeri, që është lodhur nga sakrifica.

Njeri, që i frikësohet dashurisë.

Njeri, që do kthim.

Njeri, që i frikësohet ndarjes.

Njeri, që për çdo ditë qan për ata që u larguan nga dynjaja.

Njeri, që ngrihet natën dhe qan për Allahun dhe i ankohet për brengat e tij.

Njerëz, të cilët i lexojnë këto fjalë, që ta gjejnë veten në disa prej këtyre rreshtave të lartpërmendur.

Dhe njerëz, që nuk e gjejnë veten në asnjë vend!

CILI ËSHTË SHKAKU I PIKËLLIMIT TËND?!

– Nëse është shkaku i pikëllimit tënd sëmundja, dije se ajo për ty është hair dhe përfundimi i saj është shërimi.

Allahu i Madhëruar thotë. "I Cili, kur sëmurem, më shëron." (Esh-Shuara: 80).

– Nëse është shkaku i pikëllimit tënd mëkati që e ke bërë apo gjynahu, atëherë meditoje fjalën e Allahut, i cili është më Mëshirues ndaj teje, sesa ti për vetveten.

Allahu i Madhëruar thotë: "Thuaj: "O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i Madh dhe Mëshirëploti!" (Ez-Zumer: 53)

– Nëse është shkaku i pikëllimit tënd padrejtësia e bërë nga farefisi apo të largëtit, dije se Allahu të premtoi fitore, dhe i premtoi atij që të bëri padrejtësi me humbje dhe nënçmim.

Allahu i Madhëruar me një hadith të shenjtë (kudsij) i tha të dëmtuarit: "Pasha Krenarinë dhe Madhërinë Time! Do të ndihmoj, qoftë edhe pas një kohe!"

– Nëse është shkaku i pikëllimit tënd varfëria dhe nevoja, duro dhe përgëzohu.

Allahu i Madhëruar thotë: "Sigurisht që Ne do t'ju sprovojmë me frikë dhe uri, me dëmtim të pasurisë, të njerëzve dhe të të lashtave! Prandaj, përgëzoji të duruarit..." (El-Bekare: 155)

– Nëse është shkaku i pikëllimit tënd mospasja e fëmijëve apo numri i vogël i tyre, dije se ti nuk je i pari që nuk i ke dhe ti nuk je përgjegjës për krijimin e tyre.

Allahu i Madhëruar thotë: "I Allahut është pushteti mbi qiejt dhe Tokën. Ai krijon çfarë të dojë. Ai i dhuron vajza kujt të dojë e djem kujt të dojë." (Esh-Shura: 49)

– A je ti ai që deshi të jetë steril apo Allahu me vullnetin e Tij të bëri ashtu?!

– A të takon ty ta kundërshtosh gjykimin e Allahut dhe vullnetin e Tij apo a i takon dikujt tjetër të qortojë për këtë?!

– Nëse ai e vepron këtë, atëherë ai e kundërshton Allahun e jo ty, dhe ai nuk e pranon gjykimin dhe vullnetin e Tij.

Me të vërtetë, pikëllimi, krijimi dhe çështjet, të gjitha i takojnë vetëm Allahut.

Përkthehu nga arabishtja:
Irfan Jahiu

Edukimi i fëmijëve sfida më e madhe e prindërve bashkëkohorë

Dikur, prindërit e kishin të vështirë të siguronin të ardhura të mjaftueshme për mirëqenien e familjes, e në veçanti të fëmijëve të tyre. Herë – herë e kishin të pamundur të mbulonin shpenzimet e studimeve të fëmijëve të tyre. Në kohët e sotme kanë ndryshuar gjërat. Të shumtë janë ata prindër, për të cilët nuk përbën shqetësim ana ekonomike dhe financiare, pasi sigurojnë të ardhura të mjaftueshme mujore për një jetesë të kënaqshme familjare, megjithatë ankohen dhe shprehin pakënaqësi ndaj sjelljes jo të hijshme dhe edukatës jo në nivelin e duhur të fëmijëve të tyre. Arsimimi, sigurisht ka rëndësinë e vet dhe efektet e tij të padiskutueshme në formimin e personalitetit të të rinjve, por jo domosdoshmërisht ofron edhe edukatën dhe etikën e duhur, të synuar e të shumëpritur nga familja. Ne hasim në përditshmëri, të rinj të arsimuar, por të paedukatë. Shumë prindër janë të zhgënjyer nga komunikimi i fëmijëve të tyre. Ndihen të parespektuar dhe mundi i tyre i çuar dëm.

Nga fatkeqësitë më të mëdha, që mund tu ndodhë prindërve, është pikërisht të kenë fëmijë pa pikë edukate; pa pikë respekti e nderimi. Arrogantë deri në kulm, ofendues, indiferentë ndaj njerëzve të tyre më të dashur, ndaj atyre qe u bënë sebep për ardhjen e tyre në këtë botë; ndaj atyre që sakrifikuan çdo gjë që patën, që fëmijëve të tyre të mos u mungonin gjërat më kryesore dhe elementare të jetesës. Pse jo, duke iu përgjigjur edhe tekave dhe dëshirave të tyre deri në plotësimin e tyre. Prindër, që për fëmijët e tyre kursenin edhe bukën e gojës; prindër, të cilët nuk blinin për vete rroba, si e si që fëmijët e tyre të vishen mirë e bukur (firmato); prindër, të cilët as një kafe nuk e pinin në kafene, si e si për t'u dhënë para fëmijëve të tyre që të pinin e qerasnin të tjerët nëpër kafene e restorante. Një fëmijë i tillë shndërrohet në sprovën më të rëndë për ta. Realiteti i hidhur me të cilin përballemi në shumë familje shqiptare, duhet të na nxisë të reflektojmë për prioritetet që duhet të rendisim gjatë rritjes së fëmijëve tanë.

Pritshmëritë ndryshojnë nga disa prindër te disa të tjerë në lidhje me fëmijët e tyre. Jo gjithmonë gjen prindër që i japin përparësi edukimit të fëmijëve. E kanë kuptuar gabimisht konceptin e prindërimit, duke u mjaftuar vetëm me mbulimin e nevojave të fëmijëve të tyre që kanë të bëjnë me ushqimin, veshjen, studimin, shëndetin dhe kaq. Harrojnë se fëmijët, krahas këtyre nevojave, kanë edhe shpirtin dhe të brendshmen e tyre,

që u duhet kushtuar vëmendje dhe kujdes, ndoshta dhe më shumë se këto që u përmendën më lart.

Ka prej prindërve të dështuar në edukimin e fëmijëve, që ia vënë fajin moshës delikate të fëmijëve, për veprimet e pamatura që ata bëjnë në vazhdimësi. Jo rrallëherë dëgjojmë shprehjen: "Është i ri / e re, do piqet me kalimin e kohës". Problemi qëndron te fakti se ka disa që kalojnë direkt në procesin e djegies para se të piqen mirë e mirë. Procesi i edukimit të fëmijëve përgjatë rritjes së tyre duhet mbikëqyrur me shumë kujdes, se përndryshe, po të ikën nga duart, e pamundur t'i sjellësh në binarët e duhur. Por edhe pse ka shumë prindër të përkushtuar në mirë-edukimin e fëmijëve të tyre, prapë se prapë ka raste jo të pakta kur fëmijët e tyre janë të padëgjueshëm, të papërgjegjshëm dhe të pabindur. Dëgjon shpesh nga prindërit t'i thonë njëri-tjetrit: "Ku gabuam me fëmijët tanë? Vallë, kujt i ngjanë kështu?" Ka prindër që u vjen turp nga veprimet e fëmijëve të tyre, kur përballen me miq, të afërm e të njohur. Ka prindër që mbulojnë në vazhdimësi sjelljen e keqe të fëmijëve të tyre, në biseda me të tjerët, edhe pse përbrenda vetëm shpirti i tyre e di se ç'vuan. Pavarësisht kësaj situate dhe realiteti aspak premtues, prindërit nuk duhet të dorëzohen përpara kësaj detyre madhështore të prindërimit; nuk duhet të heqin dorë kurrë, sa të jenë gjallë. Le të marrin shembullin e profetëve, të cilët ftuan drejt së vërtetës popujt e tyre, përfshirë edhe familjet e tyre, natën dhe ditën, për vite me radhë, e nuk u sprapsën, edhe pse rezultati, jo në të gjitha rastet, ishte ai i prituri. Në dorën e njeriut është përpjekja dhe në dorën e Zotit është rezultati dhe suksesi. Sido që të jetë përfundimi, para Zotit prindi i mirë del i justifikuar dhe arsyetuar kur ka sakrifikuar ç'ka pasur mundësi në procesin e mirë-edukimit të fëmijëve të tij, duke vënë në zbatim të gjitha metodat dhe mënyrat që i ka parë si të përshtatshme në këtë drejtim.

Ndër shqetësimet më kryesore për prindërit e përgjegjshëm, janë fëmijët e tyre. E kur ata nuk rezultojnë ashtu siç prindërit e tyre ëndërrojnë, shndërrohen në plagën më të madhe të prindërve që pikon gjak gjatë gjithë jetës. Ata që e kanë kaluar para nesh këtë rrugë, nuk kanë thënë kot së koti: "Fëmijët sa janë të vegjël ta prishin gjumin, ndërsa kur rriten të lënë pa gjumë". Manualin më të mirë për të qenë të suksesshëm në këtë mision e gjejmë te prindi më i mirë në mesin e njerëzve, tek i Dërguari i fundit i Allahut, Muhamedi (Paqja e Zotit qoftë mbi të), i cili edukoi një brez të tërë sahabësh me parimet më sublime dhe u dha këshillat më të vyera se si të jesh një baba dhe nënë e denjë për fëmijën, se fundja – fundit, fëmijët janë imitues të prindërve të tyre. Zoti e përmirësoftë gjendjen e të rinjve tanë! I bëftë të mbarë e të hajrit për familjet e tyre, shoqërinë, atdheun dhe pse jo, mbarë botën! Amin.

| TUGRAL CAGRI YAVUZ |

Hirudoterapia
terapia me shushunja
NJË MUNDËSI PËR SHËRIM

Sëmundjet janë pjesë e jetës sonë, por fatmirësisht njerëzimi nuk do të mbesë pa mjekim për sa kohë që do të dijë ta kërkojë atë. Në fakt, kërkimi për mjete shërimi për problemet që kemi, ka filluar që nga dita kur u krijuam dhe njohuritë e akumuluara janë shfaqur nën metoda të ndryshme të trajtimit. Ka shumë aplikime të njohura si mjekësia tradicionale, mjekësia alternative ose mjekësia plotësuese dhe që përdoren në parandalimin dhe trajtimin e shumë sëmundjeve. Akupunktura, hipnoza, terapia me kupa, terapia me larva, refleksologjia, terapia me ozon, fototerapia dhe hirudoterapia (terapia me shushunja) mund të konsiderohen në këtë kategori.

Ndonjëherë, ajo që mund të duket se është gjëja më e pamundur, mund të jetë në fakt një burim shërimi, si p.sh. shushunjat medicinale. Sot, terapia me shushunja përdoret gjerësisht në shumë vende, përfshirë SHBA, Kanada, Gjermani, Francë dhe Holandë. Vetëm në Evropë, mbi 100 milion shushunja përdoren për trajtim çdo vit. Hirudoterapia është e njohur që nga kohërat antike. Studiues të tillë si Galeni (130–201 pas Krishtit) dhe Avicena (980–1037 pas Krishtit) përfituan shumë nga shushunjat për trajtimin e disa sëmundjeve.

Megjithëse ekzistojnë rreth 700 lloje të ndryshme të shushunjave nëpër 10 gjini të ndryshme, duke filluar nga grupi Hirudinea (shushunjat) deri te dega e krimbave unazorë (Annelida), jo të gjitha mund të përdoren si mjet trajtimi. Hirudo verbana, Hirudo medicinalis, Hirudo orientalis dhe Hirudo sucki gjini, të cilat quhen shushunja medicinale, përdoren përgjithësisht për trajtim [1]. Disa shushunja mund të shkaktojnë sëmundjen Hirudiniasis, e cila shpesh rezulton në inflamacion të lëkurës, ulçerim dhe gjakderdhje të vazhdueshme në fshatarët e pyjeve.

Hirudoterapia nuk mund të përdoret në mënyrë arbitrare. Shushunjat që bashkohen me pikat e akupunkturës thithin gjak 20-60 cc për 10-20 minuta. Efekti kryesor i trajtimit nuk është heqja e gjakut nga shushunja, por sekretimi i disa substancave prej tyre gjatë thithjes së gjakut. Shushunjat medicinale si H. medicinalis dhe H. verbana ndihmojnë në trajtimin e sëmundjeve të ndryshme si venat me variçe, kirurgjia rindërtuese, shërimi i plagëve, migrena, fibromialgjia, retinopatia, artrozat, celuliti dhe veçanërisht dhimbjet e muskujve dhe kyçeve.

Samreen et al. trajtoi një pacient me sëmundje të arterieve periferike, e cila mund të çojë në vdekje si rezultat i bllokimit të arterieve në duar dhe këmbë, me Hirudoterapi përmes një regjimi trajtimi gjashtë-mujor me intervale njëjavore [2]. Në lidhje me sëmundjen e veshkave që zhvillohet për shkak të diabetit, ka edhe studime mbi kafshët që hetojnë efektet e proteinës me emrin Hirudin, që lirohet nga gjëndrat në gojën e shushunjës që parandalon mpiksjen e gjakut [3].

Në studimet e fundit shkencore, theksohet se shushunjat e përdorura për trajtim duhet të vijnë nga fermat prodhuese me kushte optimale higjienike. Shushunjat e mbledhura rastësisht nga mjedise natyrore mund të paraqesin rrezik në varësi të gjendjes së rajonit dhe pranisë së metaleve të rënda në ujërat ku ata jetojnë, edhe nëse janë një lloj i shushunjës medicinale. Për shembull, Keser et al. deklaroi se shushunjat e mbledhura nga Karagol, Adiyaman, Turqi, përmbanin metale të rënda si kadmium, bakër, mangan, nikel, plumb dhe zink [4]. Në një studim tjetër, u shpreh se terapia e shushunjës mund të shkaktojë gjendje të lëkurës siç është hiperplazia limfoide kutane [5].

Shushunjat injektojnë një sekrecion që përmban rreth 20 molekula të ndryshme bioaktive ndërsa thithin gjakun e një pacienti [6]. Këto substanca kanë karakteristika lehtësuese të dhimbjes, anti-mpiksje dhe grumbullimit të trombociteve që parandalojnë ngjitjen dhe grumbullimin e qelizave të mpiksjes. Përveç kësaj, efektet e dobishme të tilla si balancimi i presionit të gjakut, duke vepruar si një antidepresiv, antibakterial dhe antioksidant kanë çuar në përdorimin e gjerë të terapisë së shushunjës (shih Tabelën 1). Përveç të gjitha këtyre përfitimeve, pretendohet se ajo gjithashtu ka efekte relaksuese të muskujve dhe qelizave nervore.

Lloji i Efektit	Përbërësi Aktiv
Lehtësim i dhimbjes dhe efekt anti-inflamator	antistasin, LDTI (leech-derived tryptase enzyme inhibitor), hirustacin, ghilantens, eglin C, karboxypeptidase suppressor, boellin
Shkatërrimi i substancave rreth qelizave	hyaluronidase, collagenase
Rritja e rrjedhës së gjakut	acetylcholine dhe molekulat e ngjashme me histaminen
Supresioni i trombociteve (kundër koagulimit)	saratina, kalina, adenosine difosphati, dekorsina
Efekti i shkrirjes së koagulit	hirudina, gelina, frenuesi I faktorit Xa, destabilase
Efekt antimikrobik	destabilase, kloromycetin, thromizin, peptidi B

Tabela 1: Molekulat kryesore bioaktive në sekrecionin e shushunjës.

Është raportuar se polipeptidet aktive që gjenden në sekrecionin e shushunjave janë të dobishme për të luftuar inflamacionin në qelizat e enëv e të gjakut. Lu et al. gjithashtu raportoi se ekstrakti i lëngshëm i shushunjës parandalon vdekjen e qelizave të makrofagëve në sistemin imunitar dhe u zgjat jetën, parandalon formimin e shkumës dhe vepron si një ilaç kundër arteriosklerozës [7]. Ky ekstrakt i marrë nga shushunjat është treguar në eksperimente se shërben për të parandaluar hyrjen e tepërt të kolesterolit në qelizat vaskulare përmes mekanizmit të Lipoxygenase 1 dhe Lipoxygenase XR-a, dhe është sugjeruar që ashpërsia e arteriosklerozës mund të zvogëlohet në këtë mënyrë.

Zona e trupit në të cilën do të ngjitet shushunja duhet të pastrohet plotësisht me antiseptikë para se të fillojë terapia e shushunjës. Ajo largohet nga kjo zonë e lëkurës pasi thith gjak për 10-20 minuta, derisa pesha e saj të rritet 2-8 herë, duke thithur ujë dhe kripë nga gjaku. Shushunja që nuk bie vetë nuk duhet të nxirret kurrë me dorë. Pas rënies së shushunjës, gjakderdhja mund të vazhdojë për 4-10 orë si rrjedhje e lirë. Në disa pacientë, mund të shfaqen efekte anësore të lëkurës, të tilla si kruajtje, formim flluskash të vogla, nekrozë dhe reaksion alergjik. Nëse shushunja nuk largohet nga vendi i thithur edhe pas 20 minutash, atëherë duhet të përdoren 10% acid tartarik, kripë ose uthull për të mpirë shushunjën për tu lëshuar.

Mjekësia ka filluar të rizbulojë terapinë e shushunjës, e cila është konsideruar si një metodë e vjetruar trajtimi për vite me radhë, por që është provuar e dobishme në trajtimin e shumë sëmundjeve si rezultat i studimeve shkencore.

Kjo krijesë e vogël është e bekuar me një nofull të mprehtë. Me këtë nofull, shushunja thith gjakun tonë pa na dëmtuar duke e mpirë më parë lëkurën dhe ndihmon në zbrazjen e gjakut të ndotur për shumë kohë në kapilarët e lëkurës. Ndërkohë, injekton rreth 20 molekula të dobishme bioaktive në gjakun tonë. Këtyre krijesave, të cilat ne i nënvlerësojmë kur i shohim, u është dhënë mekanizmi për të prodhuar një anestetik lokal të veçantë dhe për të prodhuar antikoagulantë për të parandaluar mpiksjen e gjakut tonë. Nëse shushunja nuk vjell pas thithjes së gjakut, atëherë ajo mund të mbijetojë për gjashtë muaj pa ngrënë ose pirë asgjë tjetër. Pas thithjes së këtij gjaku, serumi i gjakut ndahet në organizmin e shushunjës (një proces i cili është i mundur vetëm me centrifugimin në laboratorë), ruhet në xhepa të veçantë dhe përdoret si ushqim kur është e nevojshme. Bakteret speciale të quajtura P. hirudinus, të gjetura në zorrët e shushunjave kanë për detyrë të sigurojnë që gjaku i thithur nga shushunja të përdoret në mënyrë efikase. Studimet afatgjata janë të nevojshme për të zbuluar se si terapia e shushunjës mund të jetë kurative, në cilat sëmundje dhe sa shpesh duhet të zbatohet. Hirudoterapia është një metodë trajtimi që ka më pak efekte anësore sesa trajtimet ekzistuese të ilaçeve, është e natyrshme, ekonomike dhe praktike.

Përktheu: Erion Sukaj

Referenca

1. Syed Hasan, Tanwir Alam, Leech therapy in traditional medicine: Hirudotherapy, 2015.
2. Samreen Ilyas et al. Management of tasallube sharain (Peripheral artery disease) by hirudotherapy: A case report. Advances in Integrative Medicine. 2019.
3. Hongwu Wang et al. The effects of a hirudin/liposome complex on a diabetic nephropathy rat model. Bmc Compl Alternative Med, 19 (1), 118 2019 Jun 6.
4. Gonca Keser, Yusuf Topak, Yusuf Sevgiler. Concentrations of some heavy metal and macroelements in sediment, water, macrophyte species, and leech (hirudo sulukii n. sp.) from the Kara Lake, Adiyaman, Turkey. Environmental Monitoring and Assessment, 192 (2), 75 2020 Jan 22.
5. Maryam Sadat Sadati et al. Cutaneous lymphoid hyperplasia induced by hirudo medicinalis (leeches). J Complement Integr Med, 16 (4) 2019 Dec 4.
6. Ali K. Sig et al. Medicinal leech therapy-an overall perspective. Integr Med Res, 6 (4), 337-343 Dec 2017.
7. Lu J, Sun L. Active polypeptides from Hirudo inhibit endothelial cell imflammation. J Brobha, 2019.

LETËR MËSUESIT!

Në një shkollë, një mësuese zëvendësonte një mësuese tjetër, e cila ishte me leje lindje.

Mësuesja filloi të shpjegonte mësimin.

Ajo pyeti njërin nga nxënësit që rrinte vetmuar dhe më pas të gjithë nxënësit filluan të qeshin...

Mësuesja mbeti e habitur nga gjesti i tyre duke u menduar me vete: "Përse qeshin pa arsye?"

Më pas, me aftësitë e saj, ajo arriti të kuptonte sekretin përse nxënësit e tjerë qeshnin, dhe arsyeja ishte se, ajo kishte pyetur një nxënës që, sipas tyre, ishte nxënës i dobët dhe jo i aftë për t'iu përgjigjur pyetjes së saj.

Por mësuesja nuk u tha gjë. Mbaroi mësimi, të gjithë nxënësit dolën...

Ajo thirri nxënësin e vetmuar dhe hynë në klasë, mori dhe shkroi një poezi dhe ia dha nxënësit, i tha: Ta mësosh përmendsh këtë poezi sikurse emrin tënd dhe mos i trego askujt!

Ditën tjetër mësuesja shkroi në tabelë po të njëjtën poezi që ua kishte shkruar nxënësve një ditë më parë dhe e shpjegoi në formë të hollësishme kuptimin e saj, pastaj e fshiu nga tabela dhe pyeti nxënësit: kush nga ju mësoi përmendsh poezinë, le ta ngrejë dorën!

Askush nga nxënësit nuk e ngritën dorën, përveç atij nxënësi, i cili u ngrit dhe e tha poezinë përmendsh.

Mësuesja e falënderoi dhe e lavdëroi nxënësin, dhe urdhëroi që të gjithë nxënësit të duartrokasin.

Nxënësit mbetën të çuditur! Kjo gjë u përsërit një javë rresht me metoda të ndryshme, lavdërime, mburrje nga mësuesja dhe duartrokitje nga nxënësit.

Pikëpamja e nxënësve filloi të ndryshonte drejt atij nxënësi.

Gjendja psikike e nxënësit filloi të ndryshonte për mirë.

Filloi të ketë vetëbesim në vete edhe më shumë, dhe nuk ishte ashtu si e përshkruante mësuesja e mëparshme.

Arriti deri në atë masë saqë ndiente në vete që ishte i gatshëm të garonte me nxënësit e tjerë dhe të ishte më i suksesshëm sesa ata.

U afrua përfundimi i vitit, mbërriti koha e provimeve.

Nxënësi punoi shumë... u tregua këmbëngulës... i kaloi me sukses të gjitha lëndët.

U regjistrua në shkollën e mesme me shumë vetëbesim dhe interesim të lartë. Arriti edhe më shumë suksese... arriti notë mesatare të lartë dhe u regjistrua në fakultet.

Nuk mbaroi me kaq, vazhdoi t'i ndiqte mësimet pasuniversitare në nivel master dhe doktoratë.

Domethënia e tregimit

Njerëzit janë dy lloje:

• Njeri - çelës i së mirës, mbyllës i së keqes; stimulon, inkurajon, të merr për dore, të jep shpresë dhe optimizëm, ndien ndjenjën e të tjerëve, njeri pozitiv dhe mesazhdhënës.

• Njeri - mbyllës i së mirës, hapës i së keqes; dekurajues, dëshpërues, nuk ka detyrë tjetër përveç vendosjes së pengesave dhe vështirësive para çdo gjëje serioze, shpërthen në të ankuar, njeri që humb çdo mbresë dhe shpresë.

TREGIM

Njëri nga nxënësit e Imam Ebu Hanifes, Hasan bin Zijadi, tregon:

Një njeri kishte groposur të gjitha paratë e tij por më vonë e kishte harruar vendin se ku i kishte groposur. I mërzitur, erdhi tek imami dhe i tregoi se çfarë i kishte ndodhur. Imam Ebu Hanifja i tha: Këtë natë kaloje duke bërë adhurime ndaj Zotit dhe do të kujtohesh!

Nuk kishte kaluar më tepër se çerekun e natës me adhurim, ku iu kujtua vendi. Menjëherë erdhi tek imami dhe i tha: Si e kuptove këtë gjë?

Imami i tha: "Patjetër që shejtani nuk dëshiron që ti t'a kalosh natën me adhurim e falënderim, prandaj ta ka kujtuar. Por ti përse nuk vazhdove të kryeje adhurim edhe gjatë pjesës tjetër të natës, për të falënderuar Allahun?"

“SHFRYTËZO PESË GJËRA, PARA SE TË TË VIJNË PESË TË TJERA:
JETËN PARA VDEKJES.
SHËNDETIN PARA SËMUNDJES.
PASURINË PARA VARFËRISË.
RININË PARA PLEQËRISË.
KOHËN E LIRË PARA SE TË ANGAZHOHESH (ME PUNË).”

- PROFETI MUHAMED A.S.

BOTIMET KMSH

MUND TA GJENI PRANË LIBRARISË “MIQTË E LIBRIT”

BOTIM I RI

Kolana me titull “Kurani dhe njeriu” është një ribotim i 10 librave serial po me të njëjtën titull, shkruar nga profesori i nderuar, z. Xhemal Balla. Kjo kolanë vjen si botim i KMSH-së me 10 vëllime, e cila i serviret lexuesit në një stil të thjeshtë dhe të konsoliduar. Përmbajtja e saj është tregues i një materiali të pasur, me tematika të larmishme dhe i një informacioni të gjerë jo vetëm në aspektin fetar, por edhe në atë shkencor, moral, letrar e sociologjik.